



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Nr. Regj. Themeltar 1601/2078
Data e regj. 07.04.2022

Nr. Vendimi 1855
Data 22.07.2022

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

GJYQTARE: REXHINA MERLIKA

Asistuar nga sekretar gjyqësor Shefqet Shehu, sot në Tiranë më datë **22.07.2022**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura, çështjen penale **1601/2078** akti që i përket:

KËRKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurore Ornela Rrumbullaku.

TE PANDEHUR:1.Erdit Muça, i biri i Selman dhe i Hajrie, i datëlindjes 26.06.2000, lindur në dhe banues në fshatin Kryezi, Njësia Administrative Petrelë, Tiranë, banesë private pa numër, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim 8 vjeçar, me gjëndje familjare beqar, me gjëndje gjyqësore i padënuar, hetuar me mase sigurimi “arrest ne burg”, mbrojtur ne gjykim nga Av.Melina Gjeta, zgjedhur me deklaram.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprave penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga neni 284/2, 278/3 dhe 278/4 i Kodit Penal.

2.Kadri Gjoshi, i biri i Halil dhe i Luljeta, i datëlindjes 01.05.1989, lindur në dhe banues në Tiranë, me adresë, Kombinar, Njësia Administrative Nr. 6, Rruga “Zyber Zeneli”, banesë private pa numër, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim të mesëm, me gjëndje familjare i martuar me një fëmijë, me gjëndje i dënuar, hetuar me mase sigurimi “arrest ne burg”, ne mungese ne shpallje, mbrojtur ne gjykim nga Av. Enise Kurteshi dhe Av. Tabane Jahja, zgjedhur me deklaram.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprave penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga neni 284/2 dhe 278/4 i Kodit Penal.

3.Alfred Muça, i biri i Selman dhe i Hajrie, i datëlindjes 19.08.1990, lindur dhe banues në fshatin Kryezi, Njësia Administrative Petrelë, Tiranë, banesë private pa numër, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim 8- vjeçar, me gjëndje familjare beqar, me gjëndje gjyqësore i padënuar, hetuar me mase sigurimi “arrest ne burg”., mbrojtur ne gjykim nga av. Melina Gjeta, zgjedhur me deklaram.

4.Lulzim Çullhai, i biri i Demir dhe Tije, i datëlindjes 10.01.1966, lindur në dhe banues në fshatin Kryezi, Njësia Administrative Petrelë, Tiranë, banesë private pa numër, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim te larte, me gjëndje familjare i martuar, me gjëndje gjyqësore i padënuar, hetuar me masen e sigurimi “Detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqesore” identifikuar me leternoftim me nr. G60110044K, mbrojtur ne gjykim nga Av. Alfred Bari, zgjedhur me deklaram.

5.Gerti Gjoshi, i biri i Halil dhe i Luljeta, i datëlindjes 15.08.1985, lindur në dhe banues në fshatin Hekal, Njësia Administrative Petrelë, Tiranë, banesë private pa numër, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim 8- vjeçar, me gjëndje familjare i martuar me tre fëmijë, me gjëndje gjyqësore i padënuar, hetuar me mase sigurimi “arrest ne shtepi” idetinfikuar me leternjoftim me nr. I50815045T, mbrojtur ne gjykim nga Av.Enea Cenka, zgjedhur me deklaram.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal.

6.Dashamir Hasanaaj, i biri i Bilal dhe i Bukurije, i datëlindjes 05.04.1987, lindur në Përcëllesh dhe banues në Tiranë, me adresë Shkozë, Rruga e Luleve, banesë private pa numër, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim 8- vjeçar, me gjëndje familjare i martuar me një fëmijë, me gjëndje gjyqësore i padënuar, hetuar me mase sigurimi “arrest ne burg” e me pas “arrest ne shtepi” idetinfikuar me leternjoftim me nr. I70305065Q, mbrojtur ne gjykim nga Av.Alfred Bari, zgjedhur me deklaram.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale “Moskallezim Krimi”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga nenet 300, 278/4 dhe 280 te Kodit Penal.

7.Xhevrije Muça, e bija e Xhemal dhe Sajde, e dtl. 22.06.1950, lindur dhe banuese ne Kryezi, Tirane, shtetesi e kombesi shqiptare, arsimi fillor, e martaur, e padenuar, hetuar ne gjendje te lire, identifikuar me karten e identitetit me nr. personal

F05622052K, mbrojtur ne gjykim nga Av. Alfred Bari, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në prani të prokurorit, të pandehurve Erdit Muça, Alfred Muça, Lulzim Çullhai, Gerti Gjoshi, Dashamir Hasanaj, Xhevrije Muça, të mbrojtësve të tyre, ne mungese të të pandehurit Kadri Gjoshi dhe ne praninë e mbrojtëses së tij, si dëgjoi palët të cilat në konkluzionet përfundimtare kanë kërkuar:

Prokurorja 1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Alfred Muça për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” e kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 284/2 të K. Penal dënimin e tij me 5 vjet burgim. Ne zbatim të nenit 406 të K.Pr. Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin përfundimisht të të pandehurit Alfred Muça me 3 vjet e 4 muaj burgim. Prej të cilave deri më sot ka vuajtur 9 muaj e 20 ditë paraburgim, që janë të barabarta me 1 vit e 2 muaj e 15 ditë burgim dhe i mbeten për të vuajtur edhe 2 vjet e 1 muaj e 15 ditë burgim. Ne zbatim të nenit 59/1-4 të K. Penal, koha e përllogaritur më sipër të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim, me kusht që gjate 3 viteve, duke filluar nga e nesermja e shpalljes së vendimit, i pandehuri Alfred Muça, të mos kryejë veper tjetër penale dhe gjate kesaj kohe të mbaje kontakte me Zyrën e Shërbimit e Provës. Urdherohet i pandehuri Alfred Muça që gjatë kohës së provës prej 3 vjetësh, në baze të nenit 60 të K. Penal, të mos shoqerohet me persona të denuar.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Erdit Muça për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” e kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 284/2 të K. Penal dënimin e tij me 5 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Erdit Muça për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municioneve” në lidhje me municionet, të parashikuar nga neni 278/3 dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Erdit Muça për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municioneve”, në lidhje me armën luftarake, të parashikuar nga neni 278/4 dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e dënimi në një të vetëm, në atë të 5 vjet e 6 muaj burgim. Ne zbatim të nenit 406 të K.Pr. Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin përfundimisht të të pandehurit Erdit Muça me 3 vjet e 8 muaj burgim. Vuajtja e këtij dënimi të llogaritet nga momenti i ndalimit më datë 08.09.2021 dhe të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit Lulzim Çullhai për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” e kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 284/2 të K. Penal dënimin e tij me 5 vjet burgim. Ne zbatim të nenit 406 të K.Pr. Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin përfundimisht të të pandehurit Lulzim Çullhai me 3 vjet e 4 muaj burgim. Ne zbatim të nenit 59/1-4 të K. Penal, pezullimin e ekzekutimit të ketij vendimi, me kusht që gjate 3 viteve, duke filluar nga e nesermja e shpalljes së vendimit, i pandehuri Lulzim Çullhai, të mos kryejë veper tjetër penale dhe gjate kesaj kohe të mbaje kontakte me Zyrën e Shërbimit e Provës. Urdherohet i pandehuri Lulzim Çullhai që gjatë kohës së provës prej 3 vjetësh, në baze të nenit 60 të K. Penal, të mos shoqerohet me persona të denuar.

4. Deklarimin fajtor të të pandehurit Dashamir Hasanaj për veprën penale të “Moskallëzim i krimit” dhe në bazë të nenit 300 te K. Penal dënimin e tij me 1 vit burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Dashamir Hasanaj për veprën penale të “*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municioneve*” në lidhje me armën luftarake, të parashikuar nga neni 278/4 dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Dashamir Hasanaj për veprën penale të “*Mbajtjes pa leje armëve të gjuetisë*” në lidhje me armën e gjuetisë e gjetur në banesë, të parashikuar nga neni 280 dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e 3 dënimeve në një të vetëm, në atë me 2 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 te K.Pr.Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin perfundimisht të të pandehurit Dashamir Hasanaj me 1 vit e 4 muaj burgim. Vuajtja e këtij dënimi të llogaritet nga momenti i ndalimit më datë 08.09.2021 (duke u llogaritur koha e paraburgimit dhe zëvendësimi i masës së sigurimit).

5. Deklarimin fajtor të të pandehurit Gerti Gjoshi për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” e kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 284/2 te K.Penal dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 te K.Pr.Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin perfundimisht të të pandehurit Gerti Gjoshi me 3 vjet e 4 muaj burgim. Prej të cilave deri më sot ka vuajtur në total 11 muaj e 4 ditë burgim, dhe i mbeten për të vuajtur edhe 2 vjet e 6 muaj e 27 ditë burgim. Në zbatim të nenit 59/1-4 te K.Penal, koha e përlllogaritur më sipër të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim, me kusht që gjate 3 viteve, duke filluar nga e nesermja e shpalljes së vendimit, i pandehuri Gerti Gjoshi, të mos kryejë veper tjeter penale dhe gjate kesaj kohe të mbaje kontakte me Zyrën e Shërbimit e Provës. Urdherohet i pandehuri Gerti Gjoshi që gjatë kohës së provës prej 3 vjetësh, në baze të nenit 60 te K.Penal, të mos shoqerohet me persona të denuar.

6. Deklarimin fajtor të të pandehurit Kadri Gjoshi për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” e kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 284/2 te K.Penal dënimin e tij me 5 vjet burgim. - Deklarimin fajtor të të pandehurit Kadri Gjoshi për veprën penale të “*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municioneve*” në lidhje me armën luftarake, të parashikuar nga neni 278/4 dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. - Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e 2 dënimeve në një të vetëm, në atë me 5 vjet e 6 muaj burgim. - Në zbatim të nenit 406 te K.Pr.Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin perfundimisht të të pandehurit Kadri Gjoshi me 3 vjet e 8 muaj burgim. Prej të cilave deri më sot ka vuajtur 9 muaj e 20 ditë paraburgim, që janë të barabarta me 1 vit e 2 muaj e 15 ditë burgim dhe i mbeten për të vuajtur edhe 2 vjet e 5 muaj e 15 ditë burgim. - Në zbatim të nenit 59/1-4 te K.Penal, koha e përlllogaritur më sipër të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim, me kusht që gjate 3 viteve, duke filluar nga e nesermja e shpalljes së vendimit, i pandehuri Kadri Gjoshi, të mos kryejë veper tjeter penale dhe gjate kesaj kohe të mbaje kontakte me Zyrën e Shërbimit e Provës. Urdherohet i pandehuri Kadri Gjoshi që gjatë kohës së provës prej 3 vjetësh, në baze të nenit 60 te K.Penal, të mos shoqerohet me persona të denuar.

7. Deklarimin fajtor të të pandehurës Xhevrije Muça për veprën penale të “*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municioneve*” në lidhje me armën luftarake, të parashikuar nga neni 278/4 dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim. - Në zbatim të nenit 406 te K.Pr.Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin perfundimisht të të pandehurës Xhevrije Muça me 8 muaj burgim. - Në zbatim të nenit 59/1-4 te K.Penal, të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim, me kusht që gjate 16 muajve, duke filluar nga e nesermja e shpalljes së vendimit, e pandehura Xhevrije Muça,

te mos kryeje veper tjeter penale dhe gjate kesaj kohe te mbaje kontakte me Zyrën e Shërbimit e Provës.

8.Në zbatim të nenit 190 të K.Pr.Penale të urdhërohet asgjësimi i bimës, narkotike, të ambalazhuar në qese të provave me Nr.unik, të përshkruar në procesverbalin e sekuestros të mbajtur nga Of.Pol.Gjyqsore në datën 08/09/2021.

9.Në zbatim të nenit 190 të Kodit të procedurës Penale kalimin në favor të shtetit të armëve të sekuestruara si dhe municioneve, sipas procesverbaleve të sekuestrimit të datës 08.09.2021.

10.Në bazë të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, kthimin e aparateve celulare të sekuestruara gjatë hetimeve paraprake, në funksion të këtij procedimi penal respektivisht personave të cilëve janë sekuestruar.

11.Shpenzimet procedurale, i ngarkohen të pandehurve solidarisht.

Mbrojtja e të pandehurit Erdit Muça: 1. Denimin e shtetasit Erdit Muça ne nje mase sa me te bute. 2. Ne lidhje me vuajtjen e denimit, kerkojme qe gjykata te vendose pezullimin e ekzekutimit te vendimit me burgim dhe venia ne vrove, parashikuar ne nenin 59 te K. Penal, per shtetasin Erdit Muça.

I pandehuri Erdit Muça: Dakort me mbrojtësen.

Mbrojtja e të pandehurit Alfred Muça: 1. Denimin e shtetasit Alfred Muça ne nje mase sa me te bute. 2. Ne lidhje me vuajtjen e denimit, kerkojme qe gjykata te vendose pezullimin e ekzekutimit te vendimit me burgim dhe venia ne vrove, parashikuar ne nenin 59 te K. Penal, per shtetasin Alfred Muça.

I pandehuri Alfred Muça: Dakort me mbrojtësen.

Mbrojtja e të pandehurit Lulzim Çullhai: Deklarimin fajtor te te pandehurit Lulzim Çullhai per vepren penale te "Moskallzimi i krimit" te parashikuar nga neni 300 i K.Penal. Aplikimin e nenit 59 te K.Penal, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim per Pjesen e pavuajtur te tij.

I pandehuri Lulzim Çullhai: Kërkoj mëshirë.

Mbrojtja e të pandehurit Dashamir Hasanaj: Deklarimin fajtor te te pandehurit Dashamir Hasanaj per veprat penale "Moskallezim Krimi", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive" parashikuar nga neni 300 dhe 280 te Kodit Penal. Aplikimin e nenit 59 te K.Penal, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim per Pjesen e pavuajtur te tij.

I pandehuri Dashamir Hasanaj: Jam i penduar, kerkoj meshire, jam kryefamiljar, kam vajzen semure, jam i vetmi qe punoj ne familje. Kerkoj qe te denohem me kohen e paraburgimit.

Mbrojtësi i të pandehurit Gerti Gjoshi: Perfundimisht kerkojme aplikimin e nenit 59 te K. Penal.

I pandehuri Gerti Gjoshi: Dakort me avokatin.

Mbrojtja e të pandehurit Kadri Gjoshi: Duke qene se pandehuri nuk eshte person me precedent penal, ka kryer deri tani 15 muaj burgim, ka kushte te veshtira familjare kerkojme qe ndaj tij te zbatohet neni 59 K.Penal per pjesen tjeter te denimit te mbetur nga ai qe do te zbatohet nga gjykata te pezullohet vuajtja e denimit me burgim duke vene ne sherbim prove.

I pandehuri Kadri Gjoshi: Dakort me avokaten.

Mbrojtësi i të pandehures Xhevrije Muça: Jemi dakort me kerkimin e prokurores.

E pandehura Xhevrije Muça: Dakort me avokatin.

VËREN

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka sjellë për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurëve Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi, Gerti Gjoshi, Lulzim Çullhai, Dashmir Hasanaj, Xhevrije Muça, te akuzuar për kryerjen e veprave penale të "Kultivimit të narkotikëve", kryer në bashkëpunim, dhe "Mbajtjes pa leje të armëve luftarake ose municioneve", "Moskallëzimit të krimin", dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive" të parashikuara nga nenet 284/2, 278/3/4, 280 e 300 të Kodit Penal, sipas akuzave respektive, komunikuar të pandehurëve.

Nga aktet e seancës paraprake datë 28.06.2022 rezulton se te pandehurit kane kërkuar gjykim të shkurtuar, pasi nuk u parashtrua asnjë pretendim pavlefshmërie, papërdorshmërie të provave, apo kërkim për marrjen e provave të reja, duke pranuar që gjykimi të zhvillohet në gjendjen që janë aktet në fashikullin e prokurorisë të sjellë për gjykim.

Në këto kushte gjykata bazuar në nenet 403, 332/dh gërma "c" (i ndryshuar me Ligjin Nr. 41/2021) dhe nenin 405/6 të K.Pr. Penale, pasi u njoh me aktet hetimore, vendosi të procedojë me gjykim të shkurtuar, duke çmuar për zgjidhjen e çështjes penale në gjendjen që janë paraqitur aktet nga organi i akuzës, pasi jo vetëm nga te pandehurit dhe mbrojtësi e tyre nuk u paraqitën pretendime pavlefshmërie, papërdorshmërie apo marrje të provave të reja, por as nga gjykata nuk u konstatuan pavlefshmëri apo papërdorshmëri të provave.

Ky disponim i gjykatës është në përputhje me dispozitat procedurale të cilat parashikojnë gjykimet e posaçme si dhe të Vendimit Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara, sipas të cilit ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Ky gjykim i posaçëm bën që gjykimi të zhvillohet në tërësi sipas fashikullit të prokurorit, i cili kthehet në dosje gjyqësore dhe që përbën bazën e shqyrtimit të çështjes, çmuarjes dhe analizës së provave në gjendjen që kanë ardhur për gjykim.

Nga verifikimi në tërësi i akteve, rezulton se: Nga ana e Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë është referuar materiali kallëzues për veprën penale të "Kultivimit të narkotikëve", parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal. Kështu nga shërbimet e Seksionit për Krimin dhe Shërbimin e Policimit në Komunitet, janë marrë të dhëna dhe informacione se shtetasi Lulzim Çullhai, ka mbjellë bimë narkotike në pyllin e fshatit Kryezi të Njësisë Administrative Petrelë. Nga informacionet e marra në rrugë operative rezulton se aktualisht ky shtetas ka punësuar për këtë parcelë shtetasit Alfred Muça dhe Erdit Muça. Janë përpiluar disa raporte shërbimi nga ana e inspektorit të policisë së zonës të Postës së Policisë Farkë, punonjësit Afrim Harizi dhe Artan

Hasanaj në lidhje me këtë aktivitet kriminal. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 62 regjistri themeltar datë 16.07.2021 janë vendosur në përgjim këto numra telefoni. -Lulzim Çullhai 06920 52 751, (fillimisht u vendos ky numër, i cili rezultoi të ishte i gabuar dhe me pas me vendimin e dates 14.08.2021 u vendos numri 0682058260 që është në emrin e Lulzim Çullhai)-Alfred Muça 06845 42 873,-Erdit Muça 06847 32 205.

Nga materialet e transkriptuara të administruara fillimisht rezultoi se shtetasi Alfred Muça (0684542 873) komunikon me numrin 0684389830 më datë 26/07/2021 ora 08:13 (4 min e 39 sec) ku i thotë se bimët duan shumë ujë dhe se po nuk i hodhem 20 L ujë për bimë, kot merremi me to. Numri 0684389830 (që dyshohet se e ka në përdorim Gert Gjoshi) i thotë se i kam thënë Kadriut, i cili do vijë me kunatin dhe dy të tjerë që t'i japin drejtim një herë në 3 ditë ujitjen e bimëve, se bimët nuk bohën po nuk i ujite 1 herë në 3 ditë. Dhe duhen sperkat me pleh.Nga policia gjyqësore është identifikuar edhe numri i shtetasit Kadri Gjoshi (0682829632), i cili është dyshuar si i implikuar në këtë veprimtari kriminale.

Është konstatuar nga përgjimet se numri 0692052751 që u vu në përgjim për shtetasin Lulzim Çullhai, nuk i përkiste këtij të fundit, por numri në emer të shtetasit Lulzim Çullhai është numri 0682058260, numer i cili u vu ne përgjim me vendimin nr. 62/2 datë 14.08.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga ana e organit procedues është dërguar kërkesë për informacion kompanive celulare me qëllim identifikimin e plotë të përdoruesve të këtyre numrave celulare. Nga kompania One me shkresën nr.4422/1 prot datë 13.08.2021, ardhur në prokurori më datë 16.08.2021 është dërguar informacioni për identifikimin e numrave të mëposhtëm:

1. Numri 0682058260, është rregjistruar në emer të shtetasit Lulzim Çullhai.
2. Numri 0682829632, është regjistruar në emer të shtetasit Fatmir LaMuça, por në përdorim të shtetasit Kadri Gjoshi.
3. Numri 0684389830, është regjistruar në emer të shtetasit Gert Gjoshi, i datëlindjes 15.08.1985.
4. Numri 0684542873, regjistruar në emer të shtetasit Alfred Muça,
5. Numri 0684732205, në përdorim të Erdit Mucës, regjistruar në emer të shtetasit Selman Muça (babai i Alfredit dhe Erditit).

Më datë 02.09.2021 oficeri i policisë gjyqësore Isa Ahmetaj, pasi ka administruar disa transkripte përgjimi nga Sektori i Përgjimeve me procesverbalin “Mbi realizimin e përgjimit të telekomunikimeve” datë 31.08.2021 ka përpiluar informacionin si më poshtë ku ndër të tjera dyshohet se krahas vazhdimit të aktivitetit kriminal të kultivimit të narkotikëve, dyshohet se këta shtetas fshehin dhe armë luftarake në banesat e tyre ose bashkëfshatarëve të tyre.

Konkretisht nga informacioni i datës 02.09.2021 rezulton:-Ne procesverbalin e përgjimit te dt 24.08.2021, ora 21.48 minuta, ku numri telefonik 0682829632 i cili perdoret nga shtetasi Kadri Gjoshi, telefonon numrin 0684542873, i cili është numri i shtetasit Alfred Muça. Behet fjale per te vaditur bimet narkotike.

Nr 1 - Kadri Gjoshi

Nr 2 - Alfred Muça

1-Nuk bone gjo andej?

2-Ee

1-A nuk u bo gjo anej?

2-Jo jo

1-Ti ske qene, si ke pa fare?

2-Jo per zotin, u bo, u bo ca kohe. A ke terezi per nesar mbroma ti? Dalim nje xhiro?

1-Kam cunin me temperature, pranej ka ardh po, une i dal jam, sështë problem po. Te shohim nesar mbrema bojm nje rruge.

2-Po pra, po i them ene Edit une. Shif mos mer dhe ate kunatin.

1-Dru se per nesar e ka dhon, nesar e jep qind per qind telefoni per shi mo vlla, ça bohet kshu

2-Po ishalla pra. Se besoj jo

1-As mu sma do menja, thojn do ulen temperaturat, nuk e di

2-Duhet me i lag i here

1-Ishalla po hudh zoti shi o burre

2-Ishalla po e lag I here knej. Po e lagu fitum.

1-Ishalla o zot amin

2-Ishalla

1-Hajt mo, ça tbosh, hajt se ngjohemi, ngjohemi Fredo

2-Hajt se po...kur tgjej rrugen kur te dal noj nate anej poshte po ashtu te boj telefon e pime noj kafe anej nga Kombinati.

1-Po mire mire mo shpirto, kur te dush

2-Kur te dal se nuk kam dale, a kupton

1-Ne rregull

Në procesverbalin e përgjimit të dt 20.08.2021, ora 13.41 minuta, ku numri telefonik 0684732205 i cili perdoret nga shtetasi Erdit Muça, telefonon numurin 0684542873, i cili është numuri i shtetasit Alfred Muça”. Biseda bën fjalë për një armë gjahu çifte pa leje.

Nr 1 – Erdit Muça

Nr 2 - Alfred Muça

1-Ku je me?

2-Te puna

1-Skeni shku siper aaa?

2-Ku siper me?

1-Ke shpia

2-Ooo i çova ato une

1-Po kur do i montoni ju?

2-Ne darke o çun

1-Aha mire

2-Ça ka per te montu aty me?

1-Thashe se je ne shtepi ti kishe bo nje foto çiftes aty ke numri

2-Qiftes

1-Eeee

2-Nuk kuptohet

1-Po ajo tekja qe na kane blloku? A e ka pas me leje me emrin e vet babi?

2-Kush?

1-Teken qe e kemi te bllokume atje, qe e mori policia, a ka pas me emrin e vet?

2-Jo

1-Jo eee?

2-Jo jo

1-Ëhë..

2-Pse?

1-Ti kish thone nje here... I thashe atij Xhevdetit mrom, se pyeti ate ... ene mos ta morin...

2-E di se ka fol

1-Me cilin? Xhevdeti ere?

2-Po pra (nuk kuptohet vazhdimi)

1-Mire mire hajt

2-Hajt

Ne procesverbalin e pergjimit te dt 21.08.2021, ora 12.14 minuta, ku numri telefonik 0682058260 i cili perdoret nga shtetasi Lulzim Çullhai, telefonon numurin 0685661630, i cili është numri i shtetasit Dashamir Hasanaj. Biseda ben fjale per vaditjen e bimeve narkotike.

Nr 1 – Lulzim Çullhai

Nr 2 - 0685661630 (Dashamir Hasanaj)

2-He Lulo

1-Ho me ça bone

2-Hic mo.Ça bone ti? Mire?

1-U lodhe ti?

2-Jo mo

1-Takova Benin une

2-He?

1-Ne rregull fare vlla, gjigand...

2-Ka lezet

1-Po ç thu or burre

2-Po ai plehra ta hapi telefonin? Jo?

1-Ma hapi, me shkrujti shpar

2-Ëhë

1-Nuk funksiono ajo linja fare, te ajo puna

2-Ëhë? Si me ia bo?

1-Nuk e tho... nuk e mundte pompen

2-Ëhë

1-Ene ec mo, kam fillu keshu me krah tha .Kupto ti neser ka kafet ai se fejojhet, mer ate maloken

2-E pse nuk funksionojne ajo gjo gjoja

Më pas gjatë hetimit ka dalë person i interesuar dhe shtetasi Dashamir Hasanaj (nga transkriptet e administruara konkretisht nga procesverbali i transkriptimit i dates 21.08.2021 ora 21:56 minuta, rezulton:

1. Numri 0682058260 (1-Lulzim Çullhai)

2. Numri 0685661630 (2-Dashamir Hasanaj)

1-Lulzim Çullhai 1:-Ene, ska dy minuta qe me mori, jemi kater veta ne krye te detyres;

2 Dashamir Hasanaj -:Jepi pra drejtim, thuj mor budall, jepi;

1-: Hajt noten,

2-:Mire danoç, pim kafe mjes;

1-Po po hajt noten.,

Nga organi procedues në kushtet kur nga bisedat e transkriptuara kanë rezultuar se personat e dyshuar kishin në banesat e tyre edhe armë, Prokuroria Rr.Gj.Tirane i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për lejimin e kontrollit të banesave, e cila me vendimin nr.1627 Akti datë 05.09.2021 ka pranuar kërkesën e prokurorisë dhe ka lejuar kontrollin e banesave të shtetasve Alfred Muça, Erdit Muça, Lulzim Çullhai, Gert dhe Kadri Gjoshi, Xhevrije dhe Xhemal Hidri si dhe banesën e shtetasit Dashamir Hasanaj.

Shërbimet e Policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë nr.1 më datë 08.09.2021 në zbatim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kanë shkuar në banesat e personave të përmendur mesiper dhe kanë ushtruar kontroll dhe nga kontrolli i ushtruar janë gjetur armët e mëposhtme :

Nga procesverbali i kontrollit të banesës së shtetasit Bilal Hasanaj (*babai i Dashamir Hasanaj*) u gjeten : -nje pushke model 10.56mm me numer serial H4283, e cila vërehet me shul të hapur dhe bajonetë të mbyllur. -një armë gjahu teke në formë « shot gun » me numër serial AH77630-njezetë e një copë fishekë kalibri 31/56.-njëmbëdhjetë fishekë gjuetie model 12.

Nga procesverbali i kontrollit të banesës së shtetasit Xhevrije Muça u gjet :-nje pistolete zastava 6.35 kalibri 8 mm P.A T6102715 ngjyre kafe dhe metalixato me 7 shtate fisheke 8 mm, te futura ne nje qese plastike.

Nga procesverbali i kontrollit të banesës së shtetasit Halil Gjoshi (babai i Kadri Gjoshit) u gjet :-automatik tip kallashnikov model 56, me dy karikatore nr.11119745

Nga procesverbali i kontrollit të banesës së shtetasit Erdit Muça u gjet :-nje pushke model 56 nr.K01076 dhe 22 krehere me fisheke ne total 230 fisheke.

Përpos kontrolleve të banesave i pandehuri Erdit Muça ka treguar parcelën ku ishin mbjelle 55 bimë të dyshuar kanabis sativa me lartësi maksimale 3.1 m dhe lartësi minimale 2.6 m, të mbjella 1.5 m-2 m në distancë nga njëra-tjetra. Parcela ndodhej afër një përroi të quajtur « Arluk » në një distancë 20 minuta në këmbë nga benesa e vëllëzerve Muça. Po kështu në fshatin Hekal është bërë kqyrja dhe fiksimi i një parcele tjetër me 50 bime te dyshuara kanabis sativa me lartesi 1.5 m.

Në këto kushte nga ana e organit procedues është nxjerre urdhri i ndalimit për shtetasit Lulzim Çullhai, Erdit Muça, Alfred Muça, Kadri Gjoshi, Gerti Gjoshi, Dashamir Hasanaj dhe Xhemal Hidri. Ky urdhër ndalimi është vleftësuar i ligjshëm nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimi nr. 1562 datë 12.09.2021 dhe është bërë caktimi i masave të sigurimit me karakter shtrëngues “Arrest me burgim”, për personat nën hetim Alfred Muça, Erdit Muça, Lulzim Çullhai, Dashamir Hasanaj, Gerti Gjoshi dhe Kadri Gjoshi, ndërsa për personin nën hetim Xhemal Hidri është caktuar masa e sigurimit “Detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Të pyetur në cilësinë e personave nën hetim shtetasit Alfred Muça dhe Erdit Muça kanë shpjeguar të gjithë mekanizmin e kultivimit të narkotikëve. Ata kanë shpjeguar se rreth muajit maj të vitit 2021, kanë biseduar me shtetasin Lulzim Çullhai për të bërë të mundur mbjelljen dhe kultivimin e disa bimëve kanabis sativa, ku Lulzim Çullhai do ti siguronte fidanët, ndërsa dy vëllezërit do të merreshin me pjesën tjetër të kultivimit të bimëve (mbjellje, vaditje, pleherim, prashitje etj). Më pas në muajin Qershor janë angazhuar edhe personat nën hetim Kadri dhe Gerti Gjoshi të cilët së bashku me Alfredin dhe Erditin kanë mbjelle një parcele tjetër me 50 bimë të tjera duke u përkujdesur për to me vaditjen, pleherimin dhe të gjitha proceset e tjera për rritjen e tyre.

Gjatë hetimit janë administruar aktet e ekspertimit teknik të bimëve të sekuestruar si dhe aktet e ekspertimit të armëve të sekuestruara. Sipas aktit të ekspertimit teknik armësh dhe balistik nr.9079 datë 14.09.2021 rezulton si më poshtë: *“-Arma e zjarrit objekt ekspertimi me nr.KIO 1076, sekuestruar pranë banesës së shtetasve Erdit dhe Alfred Muça, më datë 08.09.2021, është pushkë gjysëm automatike luftarake e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm. Arma është në gjëndje të rregullt teknike dhe realizon qitje normalisht.-Gëzhojat e regjistruara në sistemin ARSENAL nuk u identifikuan të qitura nga arma e zjarrit pushkë model 56, me nr.KIO 1076.-240 fishekët objekt ekspertimi janë fishekë standardë luftarakë të modelit 56 dhe kalibër 7.62mm, që përdoren si municion për pushkët e modelit 56 dhe 63..... Fishekët janë në gjëndje të rregullt teknike dhe të përshtatshëm për qitje.”*

Sipas aktit të ekspertimit teknik armësh dhe balistik nr.9995 datë 01.10.2021 rezulton si më poshtë: *“-Arma e zjarrit objekt ekspertimi me nr.H4283, sekuestruar në banesën e shtetasit Dashamir Hasanaj, më datë 08.09.2021, është armë zjarri luftarake pushkë e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm. Arma është në gjëndje të rregullt teknike dhe realizon qitje normalisht.-Arma e gjahut objekt ekspertimi me nr.AH77630, kalsifikohet si armë zjarri gjuetie me një tytë, e kkalibrin 12mm dhe në gjëndjen që paraqitet është e rregullt teknikisht dhe e përshtatshme për qitje.”*

Sipas aktit të ekspertimit teknik armësh dhe balistik nr.9363 datë 20.09.2021 rezulton si më poshtë: *“-Arma e zjarrit objekt ekspertimi me nr.11119745, sekuestruar në banesën e shtetasve Gert Gjoshi dhe Halil Gjoshi, më datë 08.09.2021, është armë zjarri luftarake automatik e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm. Arma është në gjëndje të rregullt teknike dhe realizon qitje normalisht.-Gëzhojat e regjistruara në sistemin ARSENAL nuk u identifikuan të qitura nga arma e zjarrit me nr. 11119745.-45 fishekët objekt ekspertimi janë fishekë standardë luftarakë të modelit 56 dhe kalibër 7.62mm, që përdoren si municion për pushkët e modelit 56 dhe 63..... Fishekët janë në gjëndje të rregullt teknike dhe të përshtatshëm për qitje.”*

Sipas aktit të ekspertimit teknik armësh dhe balistik nr.9364 datë 20.09.2021 rezulton si më poshtë: *“-Arma e zjarrit objekt ekspertimi, sekuestruar në banesën e shtetasve Xhevrije Muça, është armë pistolete zastava e modelit 56 dhe kalibër 6.35mm. Arma është në gjëndje të rregullt teknike dhe realizon qitje normalisht.”*

Sipas aktit të ekspertimit kimik n.9165 datë 15.09.2021 për bimët e sekuestruara pranë banesës së shtetasit Erdit Muça, datë 08.09.2021, ka rezultuar se bimët objekt ekspertimi janë bimë Cannabis Sativa L.

Sipas aktit të ekspertimit kimik n.9160 datë 15.09.2021 për bimët e sekuestruara të gjetura në fshatin Hekal, datë 08.09.2021, ka rezultuar se bimët objekt ekspertimi janë bimë Cannabis Sativa L. Ato janë në fazën e lulëzimit në gjëndje të njomë dhe u thanë në laborator.

Sipas aktit të ekspertimit kimik n.9159 datë 15.09.2021 për bimët e sekuestruara të gjetura në fshatin Kryezi i Poshtëm, datë 08.09.2021, ka rezultuar se bimët objekt ekspertimi janë bimë Cannabis Sativa L. Ato janë në fazën e lulëzimit në gjëndje të njomë dhe u thanë në laborator.

Janë administruar aktet e ekspertimit teknik të aparateve celular të sekuestruar shtetasve Alfred Muça, Erdit Muça, Lulzim Çullhai, Kadri Gjoshi, Gerti Gjoshi, Dashamir Hasanaj dhe Xhemal Hidri, prej të cilave kanë rezultuar të dhëna me vlerë për hetimin.

Më konkretisht në *aktin e ekspertimit teknik kompjuterik nr. 215 datë 07.12.2021* përsa i përket aparatit celular të sekuestruar shtetasit Erdit Muça, rezulton si më poshtë: Janë rikuperuar biseda në ehatsup midis Erdit Mucës dhe numrit 0682058260, i regjistruar me emrin Fratelo, ku konstatohen dërgimi i disa fotove të bimëve kanabis sativa dhe më pas biseda konkrete ku Erdit Muça i thotë Lulzim Çullhai: *“O lul mduket se osht cun. Apo jo. Shife i her”*. Këto janë komunikime të datës 07 korrik 2021.

Po kështu janë rikuperuar biseda në ehatsup midis Erdit Mucës dhe Alfred Mucës të datës 27 korrik 2021, ku Erditi i dërgon një foto të një bime kanabis sativa dhe e pyet Alfredin: *“Erditi: “E shef gjethen në fund si jan tha. Hulli uj sonde. Nesermroma mer plen dhe prashiti. Alfredi: Po sonde do vadisim pra, Erditi: Hulli nji dor plen. Ate longun qe mka dhon ky mu. Ske me car e bon ti atje, se do fuci. Alfredi: Do e sjell fucin.”*

Po kështu nga akti i ekspertimit janë rikuperuar disa foto ku Erdit Muça mban armë luftarake në duar si dhe municione luftarake, fisheke. Sipas *aktit të ekspertimit teknik kompjuterik nr. 212 datë 06.12.2021* përsa i përket aparatit celular të sekuestruar shtetasit Erdit Muça, rezulton si më poshtë: Në rrjetin social ehatsup, janë konstatuar disa biseda midis Alfred Mucës dhe Gerti Gjoshit (0684389830) të datës 27.07.2021, sipas së cilës Gerti Gjoshi e pyet me mesazh *“Ca bone a ishe me pa andej?, dhe Alfred Muça i përgjigjet duke i dërguar një foto të një bime cannabis sativa dhe në fund Gerti Gjoshi i përgjigjet “Te mir qekan”*.

Po kështu në fashikullin hetimor janë administruar dhe biseda të tjera me vlerë për akuzën të cilat janë printuar bashkëlidhur akteve të ekspertimit teknik kompjuterik.

Faktet si më sipër provohen me provat e marra e të adminstruara në fazën e hetimeve paraprake si : Procesverbal për kqyrjen e vendit të ngjarjes datë 08.09.2021, fshati Kryezi, banesa e shtetasit Selman Muça; Procesverbal për kqyrjen e vendit të ngjarjes fshati Kryezi i Poshtëm datë 08.09.2021, Procesverbal për kqyrjen e vendit të ngjarjes fshati Hekal datë 08.09.2021, Procesverbal i kontrollit të vendeve banesa e shtetasit Halil Gjoshi datë 08.09.2021, Procesverbal i kontrollit të vendeve banesa e shtetasit Bilal Hasanaj datë 08.09.2021, Procesverbal i kontrollit të vendeve banesa e shtetasit Xhevrije Muça datë 08.09.2021, Procesverbal i kontrollit të vendeve banesa e shtetasit Dashamir Hasanaj datë 08.09.2021, Procesverbal i kontrollit të vendeve banesa e shtetasit Lulzim Çullhai date 08.09.2021, Procesverbal për sekuestrimin e provave materiale datë 08.09.2021, të të gjitha armëve dhemunicioneve të gjetura në banesat e kontrolluara mbi bazën e vendimit të gjykatës,

Procesverbal "Për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime", nga shtetasi Erdit Muça datë 08.09.2021, Procesverbal "Për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime", nga shtetasi Alfred Muça datë 08.09.2021, Procesverbal "Për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime", nga shtetasi Kadri Gjoshi datë 08.09.2021, Tabelat fotografike të administruar me shkresën nr.6419-k datë 22.09.2021 nga Komisarjati i Policisë Nr.1 Tiranë, Akt ekspertimi teknik armësh e fishekësh nr.9995 datë 01.10.2021 në lidhje me armët e gjetura në fshatin Përcëllesh në banesën e shtetasit Dashamir Hasanaj, Akt ekspertimi teknik armësh e fishekësh nr.9931 datë 30.09.2021 në lidhje me armën e gjetur në banesën e shtetasit Xhevrije Muça, Akt ekspertimi teknik nr.9363 date 20.09.2021, Akt ekspertimi teknik nr.9079 date 14.09.2021, Akt ekspertimi nr.8965 datë 13.09.2021, Akt ekspertimi kimik nr.9164 date 15.09.2021, Akt ekspertimi kimik nr.9159 date 15.09.2021, Akt ekspertimi kimik nr.9160 datë 15.09.2021, Akt ekspertimi kimik nr.9165 datë 15.09.2021, Procesverbal mbi realizimin e përgjimit të telekomunikimeve datë 13.08.2021, realizuar nga Sektori i Përgjimit të Komunikimeve Elektronike pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Procesverbale të tjera mbi realizimin e përgjimit të telekomunikimeve datë 11.08.2021, realizuar nga Sektori Përgjimit të Komunikimeve Elektronike pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Procesverbale transkriptimi nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë realizuar nga Seksioni tekniko Shkencor dhe Depërtimit dërguar me shkresën nr.1073/1 prot date 03.12.2021, Akt ekspertimi teknik kompjuterik i ekspertit Tahir Canaj nr.212 datë 20.12.2021, së bashku me DVD-të bashkëlidhur aktit, Akt ekspertimi teknik kompjuterik ekspertit Tahir Canaj nr.213 datë 04.12.2021, së bashku me DVD-të bashkëlidhur aktit, Akt ekspertimi teknik kompjuterik i ekspertit Tahir Canaj nr.214 datë 06.12.2021, së bashku me DVD-të bashkëlidhur aktit, Akt ekspertimi teknik kompjuterik i ekspertit Tahir Canaj nr.215 datë 07.12.2021, së bashku me DVD-të bashkëlidhur aktit, 21.12.2021, Akt ekspertimi teknik kompjuterik i ekspertit Tahir Canaj nr.216 datë me DVD-të bashkëlidhur aktit, Akt ekspertimi teknik kompjuterik i ekspertit Tahir Canaj nr.217 datë 21.12.2021, së bashku me DVD-të bashkëlidhur aktit, Akt ekspertimi teknik kompjuterik i ekspertit Tahir Canaj nr.218 datë 09.12.2021, së bashkume DVD-të bashkëlidhur aktit.

Mbi bazën e këtyre fakteve dhe provave, nga prokurori u parashtrua duke argumentuar se ka të dhëna të mjaftueshme për të provuar fajësinë e të pandehurve duke e konsideruar akuzën në ngarkim të të pandehurve Erdit Muça, Alfred Muça, Lulzim Çullhai, Gerti Gjoshi, Dashamir Hasanaj, Xhevrije Muça. Lidhur me individualizimin e përgjegjësive penale prokurorja parashtrori se: Nga i gjithë hetimi i kryer provohet tërësisht se i pandehuri Alfred Muça në bashkëpunim me Lulzim Çullhai dhe Erdit Muça kanë filluar aktivitetin kriminal të kultivimit të narkotikëve përgjatë muajit maj të vitit 2021, ku Lulzim Çullhai ka siguruar fidanët e rreth 60 bimeve gjatë muajit maj dhe më pas dhe 50 bimëve të tjerë përgjatë muajit qershor. Më pas ai së bashku me vëllain e tij Erdit Muça, kanë gjetur parcelen, kanë mbjellë fidanët e bimëve kanabis sativa dhe kanë vazhduar me proceset e tjera të kultivimit të bilëve narkotike. Më pas nga hetimi rezulton e provuar se janë angazhuar rreth muajit qershor dhe dy vëllezërit Gjoshi, të cilët janë përkujdesur për parcelën tjetër me 50 bimë të tjera. Vetë i pandehuri Alfred Muça e ka pranuar faktin penal për të cilën ai akuzohet.

Edhe për të pandehurin Erdit Muça provohet tërësisht angazhimi i tij i plotë në veprën penale të "Kultivimit të narkotikëve", kryer në bashkëpunim. Përpos provueshmërisë së veprës penale të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal, në ngarkim të këtij të pandehuri janë edhe dy vepra penale të tjera, ajo e "Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake", parashikuar nga

neni 278/4 të Kodit Penal, lidhur me gjetjen e armës luftarake pushkë gjysëm automatike luftarake e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm nr.KIO 1076 në afërsi të banesës, si dhe për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të municionit”, parashikuar nga neni 278/3 të Kodit Penal, lidhur me gjetjen e 240 fishekëve standardë luftarakë të modelit 56 dhe kalibër 7.62mm, brenda në banesë.Edhe për të pandehurin Lulzim Çullhai rezultojnë tërësisht e provuar pjesmarrja e tij në këtë aktivitet kriminal të “Kultivimit të narkotikëve”, krye në bashkëpunim, nëpërmjet sigurimit të fidanëve të bimëve kanabis sativa në sasinë prej 110 copë dhe më pas interesimin e tij për gjëndjen e bimëve dhe ecurinë e rritjes së tyre. Fakti penal në ngarkim të të pandehurit provohet përmes procesverbaleve të transkriptimit të përgjimeve, procesvebaleve të marrjes së të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi si dhe përmes akteve të ekspertimit teknik kompjuterik nr.212 datë 06.12.2021, nr.215 datë 07.12.2021 si dhe provave të tjera të administruara në fashikullin penal.Edhe për të pandehurin KADRI Gjoshi provohet tërësisht angazhimi i tij në veprën penale të “Kultivimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim. Vetë i pandehuri Kadri Gjoshi e ka pranuar faktin penal që i është komunikuar.

Nga ana tjetër Kadri Gjoshi ka deklaruar se ka qenë Alfred Muça ai që i ka kërkuar angazhimin dhe dhënien e ndihmës për kultivimin e bimëve dhe përkundrejt kësaj ndihme, ai do të merrte shumën prej 1000 euro. Përpos provueshmërisë së veprës penale të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal, në ngarkim të këtij të pandehuri është edhe vepra penale e “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/4 të Kodit Penal, lidhur me gjetjen e armë zjarri luftarake automatik e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm në banesën e tij. I pandehuri Gerti Gjoshi fillimisht nuk e ka pranuar akuzën, në momentin e arrestimit, por më pas e ka pranuar faktin penal dhe ka pranuar se ka shkuar për të ndihmuar vëllain e tij Kadri Gjoshi vetëm dy herë në vaditjen e bimëve narkotike. Fakti penal në ngarkim të tij provohet si me procesverbaleve të transkriptimit të përgjimeve, procesvebaleve të marrjes së të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi si dhe përmes akteve të ekspertimit teknik kompjuterik nr.212 datë 06.12.2021, nr.215 datë 07.12.2021 etj.

Në përfundim të hetimeve vleresohet se i pandehuri Dashmir Hasanaj ka konsumuar elementët e veprës penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, pasi rezultoi tërësisht e provuar se ky shtetas ka patur dijeni të plotë për veprimtarinë kriminale të kryer nga shtetasit Lulzim Çullhai, Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi dhe Gert Gjoshi dhe nuk ka njoftuar organet e policisë për njohjen e këtij fakti kriminal. Gjithashtu vlen të theksohet se nga i gjithë hetimi i kryer shtetasi Dashmir Hasanaj nuk rezultoi të jetë përfshirë me veprime aktive në këtë veprimtari kriminale. Sic rezultojnë edhe nga pyetja e personave nën hetim Alfred Muça dhe Erdit Muça, Dashmir Hasanaj nuk ka qenë i pranishëm në momentin kur Lulzim Çullhai i ka dhënë fidanët dy vëllezërve Muça si dhe nuk ka marrë pjesë asnjëherë në procesin e mbjelljes, vaditjes, pleherimit të bimëve narkotike. Në këto kushte këtij shtetasi nuk mund t’i atribuohet vepra penale e “Kultivimit të narkotikëve”, përse kohë nga hetimi i kryer nuk rezultoi e provuar që të ketë ndihmuar me veprime aktive në këtë veprimtari kriminale. Përse i përket veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, nga hetimi ka rezultuar e provuar se shtetasi Dashmir Hasanaj është kryeplak i Fshatit Përcëllesh dhe ndërkohë bimët canabis sativa janë gjetur në fshatin Kryezi dhe Hekal.

Sa më sipër nuk mund t’i atribuohet vepra penale e “Shpërdorimit të detyrës”, përse kohë shtetasi Dashmir Hasanaj, me cilësinë e kryeplakut të Fshatit Përcëllesh përgjigjet vetëm për

territorin e këtij fshati dhe jo të fshatrave të tjerë. Përpos veprës penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, ndaj këtij të pandehuri rëndojnë edhe dy vepra penale, në lidhje me një armë zjarri të gjetur në banesën e babait të Dashamirit si dhe në lidhje me një armë gjahu të gjetur gjithashtu në banesën e babait të Dashamir Hasanaj.

E pandehura Xhevrije Muça është akuzuar për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/4 të Kodit Penal, pasi në banesën e saj më datë 07.09.2021 është gjetur dhe sekuestruar me cilësinë e provës materiale një armë zjarri e llojit pistolete zastava e modelit 56 dhe kalibër 6.35mm. E pandehura që në momentin e parë e ka pranuar autorësinë e kësaj arme, duke dhënë dhe shpjegime se si e kishte gjetur rreth 2 javë më parë në një vend në afërsi të një prroi ku ajo ka disa pemë frutore. Ajo deklaron se e ka gjetur të hedhur dhe të mbështjellë me një qese dhe e ka marrë për shkak se ka patur frikë se mos e gjenin fëmijët e vegjël që kalonin aty pranë dhe kullonin gjënë e gjallë. Deklaron gjithashtu se ajo jeton vetëm në banesën e saj bashkë me bashkëshortin i cili është i paralizuar dhe në karrocë prej 6 vitesh. Përsa i përket llojit dhe masës së dënimit, organi procedues i referohet nenit 47 të K. Penal, në analizë të së cilit, kriteret për caktimin e dënimit konsistojnë në: Rrezikshmërinë e veprës penale. Përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet gjithmonë me natyrën dhe llojin e saj, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen, pasojat që ka sjellë.

Ndërsa vepra penale “Kultivim i narkotikëve” kryer në bashkëpunim, përbën krim, për të cilën ligjvënësi parashikon dënimin me burgim nga 5 vjet gjer në 10 vjet, që paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore. Rrezikshmërinë e autorit. Në lidhje me këtë element organi procedues mban në konsideratë gjendjen sociale, profesionin, arsimimin, gjendjen familjare dhe atë gjyqësore. Shkallën e fajit. Në lidhje me këtë kriter, nga tërësia e të gjithë veprimeve të të pandehurit, organi procedues thekson se ato janë kryer në formën e dashjes direkte, formë e cila përbën edhe shkallën më të lartë të fajit.

Në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në caktimin e masës së dënimit kundër autorit të veprës penale konkrete, gjykata duhet të mbajë parasysh, ndër të tjera, rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat janë faktorë të ndryshëm objektive dhe subjektive që tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të ulët ose më të lartë të veprës dhe të fajtorit. Përsa i përket në mënyrë individuale për secilin të pandehur, organi procedues mban parasysh rrethanat si më poshtë vijon: Për të pandehurin Alfred Muça, nga ana e organit procedues mbahet parasysh: Rrezikshmëria e ulët e të pandehurit, pasi rezultoi të jetë i padënuar më parë. Pranimi i fajësisë dhe bashkëpunimi me organin procedues për zbardhjen e faktit penal; Kushtet familjare të këtij të pandehuri, i cili jeton me dy prindërit, gjyshen, vëllezërit dhe motrën (sipas certifikatës familjare datë 14.09.2021 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Petrelë) dhe janë në gjendje të vështirë ekonomike. Përpos kësaj nga hetimi ka rezultuar se i pandehuri ka lidhur fejesë në muajin gusht të vitit 2021. Sa më sipër vlerësohet se janë kushtet për t’u zbatuar neni 59 i Kodit Penal, për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, pasi rrethanat e kryerjes së veprës penale si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, duke u gërshetuar me rrezikshmërinë e paktë të këtij të pandehuri si dhe me nevojat vecanërisht ato që lidhen me familjen, pasi duke qenë djali i madh i familjes, e gjithë familja pret prej tij krijimin e të ardhurave për përballimin e ekomomisë familjare.

Për të pandehurin Erdit Muça nga ana e organit procedues mbahet parasysh: Rrezikshmëria e ulët e të pandehurit, pasi rezultoi të jetë i padënuar më parë. Pranimi i fajësisë

dhe bashkëpunimi me organin procedues për zbardhjen e faktit penal, Kushtet familjare të këtij të pandehuri, të cilat janë të njëjta me ato të vëllait të tij Alfred Muça, referuar certifikatës familjare. Faktin që I pandehuri Erdit Muça akuzohet për 3 vepra penale, ku dy prej tyre janë krime dhe me rrezikshmëri të lartë shoqërore (neni 284/2 dhe 278/4) dhe një është kundravajtje penale, përse i përket "Mbajtjes së municioneve luftarake në banesë", parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal. Së më sipër vlerësohet se masa më e përshtatshme e dënimit për këtë të pandehur është ajo me burgim.

Për të pandehurin Lulzim Çullhai, nga ana e organit procedues mbahet parasysh: Rrezikshmëria e ulët e të pandehurit, pasi rezulton të jetë i padënuar më parë. Kushtet familjare të këtij të pandehuri, i cili është kryefamiljar (me dy fëmijë, sipas certifikatës familjare lëshuar nga Zyra e Njësisë Administrative Nr.2). Përpos kësaj nga aktet e administruara rezulton se i pandehuri Lulzim Çullhai vuan nga një sëmundje e rëndë që sipas aktit të ekspertimit mjek-ligjor nr. 78 datë 17.01.2022 është diagnostifikuar me anemi hemolitike autoimmune e thellë, diabet mellitus insulinovartes në shifra të pastabilizuara dhe hipertension arterial. Po kështu në konkluzion të këtij akti ekspertimi është theksuar se në stadin në të cilën ndodhen sëmundjet ato nuk mund të kurohen në kushtet e paraburgimit. Sa më sipër edhe për këtë të pandehur vlerësohet se janë kushtet për t'u zbatuar neni 59 i Kodit Penal, për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, pasi gjëndja shëndetsore e këtij të pandehuri e përligj zbatimin e këtij dënimi alternative.

Për të pandehurin Dashmir Hasanaj nga ana e organit procedues mbahet parasysh: Rrezikshmëria e ulët e të pandehurit, pasi rezulton të jetë i padënuar më parë. Pranimi i fajësisë. Kushtet familjare të këtij të pandehuri, i cili rezulton kryefamiljar sipas certifikatës familjare si dhe personalitetit të tij referuar karakteristikës së lëshuar nga Njësia Administrative Petrele nr.197/1 prot datë 02.02.2022. Por njëkohsisht organi procedues mban parasysh faktin që i pandehuri Dashmir Hasanaj akuzohet për 3 vepra penale, ku të dy prej tyre janë krime (neni 300 dhe 278/4) dhe njëra kundravajtje penale këto vepra penale (neni 280) Së më sipër vlerësohet se masa më e përshtatshme e dënimit për këtë të pandehur është ajo me burgim.

Për të pandehurin Gerti Gjoshi, nga ana e organit procedues mbahet parasysh: Rrezikshmëria e ulët e të pandehurit, pasi rezulton të jetë i padënuar më parë. Faktin se i pandehuri Gerti Gjoshi ka mbajtur fillimisht qëndrim mohues në lidhje me fajësinë dhe më pas e ka pranuar atë. Megjithatë nga hetimi i kryer ka rezultuar një përfshirje vetëm në disa episode për vaditjen e bimëve narkotike dhe jo një angazhim i plotë sic ka rezultuar për të pandehurit e tjerë. Kushtet familjare të këtij të pandehuri, i cili është kryefamiljar me 3 fëmijë të mitur (13, 10 dhe 7 vjec), Sa më sipër vlerësohet se janë kushtet për t'u zbatuar neni 59 i Kodit Penal, për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, pasi rrethanat e kryerjes së veprës penale si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, duke u gërshetuar me rrezikshmërinë e paktë të këtij të pandehuri si dhe me nevojat vecanërisht ato që lidhen me familjen, përligjin zbatimin e këtij dënimi alternativ.

Për të pandehurin Kadri Gjoshi, nga ana e organit procedues mbahet parasysh: Rrezikshmëria e ulët e të pandehurit, pasi rezulton të jetë i padënuar më parë. Faktin se i pandehuri Kadri Gjoshi ka mbajtur qëndrim pohues në lidhje me fajësinë që në fillim dhe madje ka treguar se si është angazhuar ai në këtë veprimtari kriminale duke dhënë detaje të rëndësishme për organin procedues. Po kështu nga hetimi i kryer ka rezultuar një përfshirje në disa episode për vaditjen e bimëve narkotike dhe jo një angazhim i plotë sic ka rezultuar për të pandehurit e

tjerë.Kushtet familjare të këtij të pandehuri, i cili është kryefamiljar me 1 fëmijë të mitur (3 vjec).Sa më sipër vleresohet se janë kushtet për t'u zbatuar neni 59 i Kodit Penal, për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, pasi rrethanat e kryerjes së veprës penale si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, duke u gërshetuar me rrezikshmërinë e paktë të këtij të pandehuri si dhe me nevojat vecanërisht ato që lidhen me familjen, përligjin zbatimin e këtij dënimi alternativ.

Për të pandehurin Xhevrije Muça, nga ana e organit procedues mbahet parasysh:Rrezikshmëria e ulët e të pandehurës, pasi rezulton të jetë e padënuar më parë.Mosha e të pandehurës e cila rezulton të jetë 72 vjec si dhe faktin se ajo e ka pranuar akuzën që në fillim dhe ka dhënë të gjitha shpjegimet për rrethanat e kryerjes së veprës penale.Sa më sipër vleresohet se janë kushtet për t'u zbatuar neni 59 i Kodit Penal, për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, pasi rrethanat e kryerjes së veprës penale si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, duke u gërshetuar me rrezikshmërinë e paktë të këtij të pandehuri si dhe me moshën e saj, përligjin zbatimin e këtij dënimi alternativ.

Në përfundim nga ana e prokurorit lidhur me llojin dhe masën e dënimit është kërkuar sipas pjesës hyrëse të vendimit për secilin nga të pandehurit.

Mbrojtësja e të pandehurit Erdit Muça: I pandehuri ne fjale e ka pranuar fajësinë e plotë, në lidhje me akuzat e ngritura ndaj tij. Për sa i përket llojit dhe masës së dënimit për të pandehurin Erdit Muça Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit duhet ti referohet nenit 47 të Kodit Penal i titulluar "Mënyra e caktimit të dënimit" i cili parashikon se "Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese". Individualizimi i dënimit është një parim specifik i institutit të dënimit, që lidhet drejtpërdrejtë si me llojet dhe masat e dënimit të mundshëm të parashikuar nga ligjvënësi, ashtu edhe me dënimin konkret që caktohet nga gjykata ndaj autorit të veprës penale. Në këto kushte, bazuar edhe në nenet 47-49 të K.Penal. Gjykata duhet te çmoj se, rrethanat e kryerjes së veprës penale në tërësi janë lehtësuese për të pandehurin në gjykim. Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer nga i pandehuri dhe rrezikshmëria shoqërore e vetë të pandehurit është e tillë, sa që e nuk bën të domosdoshëm dhe të nevojshme vazhdimin e izolimit të tij nga shoqëria. Duke patur parasysh faktin faktin se i pandehuri tregon pendim të thellë dhe pranues ndaj faktit penal, është treguar bashkepunues ne te gjitha format me organin e akuzes, e shikojme te arsyeshme ti kerkojme gjyakes aplikimin e kerkesave te nenit 59 i K.Penal, kjo pasi duke patur parasysh dhe kohen e paraburgimit qe i pandehuri ka kryer i izoluar nga shoqeria, ka sherbyer per rehabilitimin e tij, dhe ligji ne vetvete e ka kryer efektin e tij mbi kete shtetas.

Perfundimisht kerkojme:1. Denimin e shtetasit Erdit Muça ne nje mase sa me te bute. 2. Ne lidhje me vuajtjen e denimit, kerkojme qe gjykata te vendose pezullimin e ekzekutimit te vendimit me burgim dhe venia ne vrove, parashikuar ne nenin 59 te K. Penal, per shtetasin Erdit Muça.

Mbrojtësja e të pandehurit Alfred Muça: I pandehuri ne fjale e ka pranuar fajësinë e plotë, në lidhje me akuzat e ngritura ndaj tij. Për sa i përket llojit dhe masës së dënimit për të pandehurin Alfred Muça Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit duhet ti referohet nenit 47 të Kodit Penal i titulluar "Mënyra e caktimit të dënimit" i cili parashikon se "Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e

dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese". Individualizimi i dënimit është një parim specifik i institutit të dënimit, që lidhet drejtpërdrejtë si me llojet dhe masat e dënimit të mundshëm të parashikuar nga ligjvënësi, ashtu edhe me dënimin konkret që caktohet nga gjykata ndaj autorit të veprës penale. Në këto kushte, bazuar edhe në nenet 47-49 të K.Penal Gjkata duhet të çmojë se, rrethanat e kryerjes së veprës penale në tërësi janë lehtësuese për të pandehurin në gjykim. Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer nga i pandehuri dhe rrezikshmëria shoqërore e vetë të pandehurit është e tillë, sa që e nuk bën të domosdoshëm dhe të nevojshme vazhdimin e izolimit të tij nga shoqëria. Duke patur parasysh faktin faktin se i pandehuri tregon pendim të thellë dhe pranues ndaj faktit penal, është treguar bashkëpunues në të gjitha format me organin e akuzes, e shikojme të arsyeshme të kërkojmë gjyqtes aplikimin e kërkesave të nenit 59 të K.Penal, kjo pasi duke patur parasysh dhe kohën e paraburgimit që i pandehuri ka kryer i izoluar nga shoqëria, ka shërbyer për rehabilitimin e tij, dhe ligji në vetvete e ka kryer efektin e tij mbi këtë shtetas. **Perfundimisht kërkojmë: 1. Dënimin e shtetasit Alfred Muça në një masë sa më të butë. 2. Në lidhje me vuajtjen e dënimit, kërkojmë që gjykata të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe venia në vrovë, parashikuar në nenin 59 të K. Penal, për shtetasin Alfred Muça.**

Mbrojtësi i të pandehurit Lulzim Çullhai: Në caktimin e masës dhe llojit të dënimit, i kërkojmë gjyqtes që të mbajë parasysh rrethanat lehtësuese të parashikuara nga nenet 48 e 49 të K.Penal. Faktet se: 1. Lulzim Çullhaj është dignostikuar prej shumë kohësh me "insuficencë kardiakë", për të cilën ai vazhdon që të trajtohet duke artitur që ta mbajë nën kontroll deri më sot. Fakti i cili vërtetohet dhe nga kartela klinike e tij pranë Qendres Spitalore Universitare "Nënë Tereza", ku rezulton se shtetasi Lulzim Çullhaj është shtruar pranë këtij insitucioni disa here për të marrë trajtimin për sëmundjen e tij. Sëmundje kjo e cila rezulton që të jetë agravuar gjatë periudhës kohore ku kërkuesi Lulzim Çullhaj është diagnostikuar me COVID 19, ku përveç sëmundjes që kishte ju shfaqur dhe sëmundja e diabetit, për të cilën ai trajtohet tre here në ditë me insulinë. 2. Gjithashtu i kërkojmë gjyqtes që të vlerësojë dhe rrethanat familjare në të cilën ndodhet aktualisht familja e kërkuesit Lulzim Çullhai. Pasi kërkuesi Lulzim Çullhaj është i vetmi person i cili siguron të ardhurën për familjen e tij dhe mbajtja në izolim e tij i shkakton një dëm të madh ekonomik familjes së tij, po ashtu dhe të punësuarve që rezultojnë pranë subjekteve të cilat administrohen nga ana e kërkuesit. 3. Fakti që është i padënuar me parë nga Gjykatat Shqiptare apo të Huaja, 4. Ka treguar pendim të thellë për veprimet që ka kryer. Për të gjitha arsyet e sipërcituara i kërkojmë Gjyqtes se Rrethit Gjyqësorë Tiranë Aplikimin e nenit 59 të K.Penal ku, për shkak të moshës së tij, faktin që i mbrojturi prej meje është i padënuar me parë nga gjykatat shqiptare apo të huaja, çka tregon për rrezikshmërinë e paket shoqërore të tij, faktin që ndodhet në gjendje të vështirë shëndetësore, i kërkojmë gjyqtes: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim parashikuar nga neni 59 i K.P për pjesën e pa vuajtur të dënimit kërkojmë të vihem në provë për vuajtjen e dënimit duke garantuar gjyqtes që jo vetëm në periudhën e provës por asnjeher i mbrojturi prej meje nuk do të kryejë veprime që bien në dëshirë me legjislacionin në fuqi. **Perfundimisht kërkojmë: Deklarimin fajtor të të pandehurit Lulzim Çullhai për veprën penale të "Moskallzimit të krimin" të parashikuar nga neni 300 i K.Penal. Aplikimin e nenit 59 të K.Penal, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim për pjesën e pavuajtur të tij.**

Mbrojtësi i të pandehurit Dashmir Hasanaj: Ne lidhje me masen dhe llojin e denimit i kërkojme Gjykatës të ketë parasysh rrethanat lehtësuese parashikuar nga nenet 48 dhe 49 të K.Penal si në uljen e masës së denimit të kërkuar nga organi i akuzës, po ashtu dhe në llojin e denimit, për këto arsye kryesore: 1. Fakti që tregon pendimin të thellë për veprimet e kryera. 2. Kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe në këto kushte kur rrezikshmeria shoqërore e të pandehurit dhe e vepres është e vogël. 3. Fakti është treguar bashkëpunues me organet proceduese dhe ka ndihmuar në zgjidhjen perfundimtare të çështjes. 4. Fakti që është i vetmi person i cili mund të punojë në familjen e tij. 5. Fakti që është me një femijë të mitur. Në lidhje me masën e kërkuar nga organi i akuzës për të mbrojturin prej meje Dashmir Hasanaj, mendojme se i është renduar pozita procedurale e tij, pasi janë të gjitha rrethanat për të aplikuar nenin 53 të K.Penal. Në kuptim të nenit 53 të K.Penal i cili i jep të drejtë gjykatës të zbusë denimin për shkak të rrezikshmerisë së autorit të vepres penale ku: Neni 53 i K.Penal parashikon se:....gjykata, në rast të veçanta, kur çmën që vepra penale dhe autori i saj paraqesin rrezikshmeri të pakët dhe janë të pranishme disa nga rrethanat lehtësuese dhe nuk është e pranishme asnjë rrethanë rënduese, ka të drejtë të caktojë një denim më të butë se ai që parashikon dispozita perkatëse. Në kuptim të kësaj dispozitive të K.Penal, arsyetojmë se rrezikshmeria e autorit dhe e vepres penale është e ulët dhe në këto kuader i drejtohemi gjykatës për të aplikuar një denim nën kufijtë e parashikuar nga ligji, duke zbutur masën e denimit nën kufijtë e parashikuar në ligj. Perfundimisht kërkojme: Deklarimin fajtor të të pandehurit Dashmir Hasanaj për veprat penale “Moskallezim Krimi”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive” parashikuar nga neni 300 dhe 280 të Kodit Penal. Aplikimin e nenit 59 të K.Penal, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim për Pjesën e pavuajtur të tij.

Mbrojtja e të pandehurit Kadri Gjoshi: Sikunder jemi shprehur edhe në seancën paraprake, i pandehuri Kadri Gjoshi duke u treguar i sinqertë dhe penduar para organit të akuzës, mbasi ka qenë i pandehuri tjetër Alfred Muça ai që e ka angazhuar për ta ndihmuar për rritjen e bimeve narkotike, ka pranuar ta ndihmonte për vaditjen e tyre në një parcelë. I pandehuri Kadri nuk ka patur lidhje me asnjë nga personat e akuzuar për këto vepra penale, dhe ai vet vetëm në rreth 3-4 raste ka ndihmuar Alfredin për vaditjen e bimeve narkotike, duke mos patur asnjë bashkëpunim me personat e tjetër, të akuzuar nga organi prokurorësh. Ai nuk e di se kush e ka mbjellë bimën, vetëm është kërkuar të ndihmojë në disa raste në vaditjen e tyre dhe se fundi u largua fare dhe nuk e di se çfarë është bërë me bimët e mbjella nga të tjerë persona. Po kështu pandehuri akuzohet se në kontrollin që është bërë në banesën e babait të tij në momentin e ndalimit në catinë e shtëpisë së babait është gjetur një armë automatik, të cilën e ka lënë i pandehuri disa vjet më parë dhe se atë armë e ka gjetur në një perrua dhe për të cilën nuk kishte dijeni asnjë nga familjarët e tij. I pandehuri duke e marrë rutinën e dritës dhe e punës e kishte haruar fare që e kishte lënë këto armë në catinë e shtëpisë së babait. Duke qenë se i pandehuri e ka pranuar akuzën dhe që në fillim të procedimit është treguar i sinqertë mbi gjithçka që ka bërë dhe njëkohësisht shumë penduar me të drejtë u procedua me gjykim të shkurtuar. Por nga gjykata në zbatimin e masës së denimit ndaj të pandehurit duhet të kihet parasysh rrethanat lehtësuese të parashikuara nga neni 48, c pandehuri ka treguar pendim të thellë, është treguar i sinqertë, nuk është denuar ndonjëherë për ndonjë vepra penale, se është i martuar dhe ka një femijë të mitur në ngarkim. Është sëmurë dhe për të po ju sjellim edhe një epikrizë që ka qenë i shtruar në spital se ka dy prinder në moshë të vjetër dhe të dy të sëmurë ku si babai dhe nëna kurohen në qendrën komunitare të shëndetit mendor nr.1, të dy kanë nevojë, duke qenë me sëmundje mendore për një kujdes të shtuar ndaj tyre dhe kjo gjendje është renduar shumë pas arrestimit të të pandehurit

duke e vujtur nga ana psikologjike. Duke qene se pandehuri nuk eshte person me precedent penal, ka kryer deri tani 15 muaj burgim, ka kushte te veshtira familjare kerkojme qe ndaj tij te zbatohet neni 59 K.Penal per pjesen tjetere te denimit te mbetur nga ai qe do te zbatohet nga gjykata te pezullohet vuajtja e denimit me burgim duke vene ne sherbim prove.

Vlerësimi i Gjykatës.

Në rastin konkret ndodhur përpara faktit të parashtruar me sipër, pretendimeve dhe provave në gjykim, gjykata çmon se veprimet e të pandehurit Erdit Muça, formojnë elementët e veprave penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga neni 284/2, 278/3 dhe 278/4 i Kodit Penal, veprimet e të pandehurit Kadri Gjoshi formojnë elementët të veprave penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga neni 284/2 dhe 278/4 i Kodit Penal, veprimet e të pandehurëve Alfred Muça, Lulzim Çullhai dhe Gerti Gjoshi formojnë elementët të veprave penale “Kultivimi i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal, veprimet e të pandehurit Dashmir Hasanaj formojnë elementët të veprave penale “Moskallezim Krimi”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga nenet 300, 278/4 dhe 280 te Kodit Penal, veprimet e të pandehurit Xhevrije Muça formojnë elementët të veprave penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal.

Gjykata vëren se për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është e nevojshme që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar të veprës penale, të parashikuar nga ligji penal. Respektimi dhe plotësimi i elementeve të figurës së veprës penale, si dhe cilësimi i saktë i veprës penale të kryer, ka rëndësi të madhe, sepse ka të bëjë me zbatimin e parimit të ligjshmërisë dhe parimit të proporcionalitetit. Për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive.

Neni 284 i Kodit Penal parashikon se: “1. Kultivimi i bimëve, që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, pa leje dhe autorizim sipas ligjit, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. 2. Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. 3. Organizmi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”.

Gjykata, me qëllim zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, vlerëson të analizojë elementet e veprës penale të pretenduar dhe t’i ballafaqojë veprimet e kryera me elementët ligjore të parashikuar nga ligji penal.

Nga pikëpamja e objektit të veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284/2 paragrafi i parë i Kodit Penal, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar ndalimin e kultivimit të bimëve narkotike apo substancave psikotrope, që drejtohen kundër rendit e sigurisë publike si dhe kundër jetësë shëndetit të njeriut, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale. Koncepti ligjor i “Kultivimit” jepet nga Ligji nr.8750, datë 26.03.2001, “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike dhe psikotrope”, ku në nenin 2, pika 3 e tij jepet përkufizimi: “Kultivim” kuptohet veprimtaria e kryer për prodhimin e bimëve që përmbajnë substanca narkotike ose psikotrope, ose që mund të

përdoren për nxjerrjen e substancave narkotike ose psikotrope". Edhe në analizë leksikore-gjuhësore rezultuar nga fjalori shqip-shqip, por edhe nga konteksti i fjalorëve të disa shteteve anëtare të BE-së, rezulton se fjala "*kultivim*" ka tekstualisht kuptimin e "*punimit të një toke, terreni, etj., mbjelljen e farës së bimës ose pemës dhe kujdesin për të duke e punuar, vaditur, krasitur, korrur, etj., derisa të prodhohen frytet e duhura*".

Në rastin konkret, ky objekt është cenuar nga te pandehurit Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi, Gerti Gjoshi, Lulzim Çullhai, në bashkëpunim njeri tjetrin me veprimet e tyre të drejtpërdrejta dhe të kundërligjshme, veprime të cilat do t'i analizojmë më poshtë në analizë të anës objektive të kësaj figure krimi, kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar ndalimin e kultivimit të bimëve narkotike, kundër rendit e sigurisë publike si dhe kundër jetës e shëndetit të njeriut.

Nga pikëpamja e anës objektive krimi kryhet me anë të kultivimit të bimëve që shërbejnë apo dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e bimëve narkotike apo psikotrope, pa leje dhe autorizim të organeve shtetërore kompetente sipas ligjit. Nga ana objektive mjafton të jetë kryer me veprime si "*mbjelljen e farës së bimës ose pemës dhe kujdesin për të duke e punuar, vaditur, krasitur, korrur, etj., derisa të prodhohen frytet e duhura*", pa pasur nevojë për pasojë, pra është një vepër në thelb formale e cila nuk kërkon ndonjë pasojë për të sjellë efekte penale. Në çështjen konkrete, gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kjo vepër penale është konsumuar nga i pandehuri Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi, Gerti Gjoshi, Lulzim Çullhai, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, nëpërmjet kultivimit të bimëve narkotike, në mënyrë të kundërligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme. Në rastin konkret, sikurse është parashtruar në rrethanat e çështjes, rrethana këto të provuara nga tërësia e akteve të procedimit penal nr.4965/2021, te pandehurit në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë ndërmarrë veprime me qëllim kultivimin e bimëve narkotike të llojit "cannabis sativa L", të provuara si të tilla nga aktet e ekspertimit kimik n.9165 datë 15.09.2021 për bimët e sekuestruara pranë banesës së shtetasit Erdit Muça, datë 08.09.2021, ka rezultuar se bimët objekt ekspertimi janë bimë Cannabis Sativa L. Gjithashtu sipas aktit të ekspertimit kimik n.9160 datë 15.09.2021 për bimët e sekuestruara të gjetura në fshatin Hekal, datë 08.09.2021, ka rezultuar se bimët objekt ekspertimi janë bimë Cannabis Sativa L. Ato janë në fazën e lulëzimit në gjëndje të njomë dhe u thanë në laborator. Edhe sipas aktit të ekspertimit kimik n.9159 datë 15.09.2021 për bimët e sekuestruara të gjetura në fshatin Kryezi i Poshtëm, datë 08.09.2021, ka rezultuar se bimët objekt ekspertimi janë bimë Cannabis Sativa L. Ato janë në fazën e lulëzimit në gjëndje të njomë dhe u thanë në laborator.

Gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se të pandehurit Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi, Gerti Gjoshi, Lulzim Çullhai, e kanë konsumuar nga ana objektive veprën penale te parashikuar nga neni 284/2 te K.Penal.Nga provat e administruara në gjykim, rezultoi se se i pandehuri Alfred Muça në bashkëpunim me Lulzim Çullhai dhe Erdit Muça kanë filluar aktivitetin kriminal të kultivimit të narkotikëve përgjatë muajit maj të vitit 2021, ku Lulzim Çullhai ka siguruar fidanët e rreth 60 bimeve gjatë muajit maj dhe më pas dhe 50 bimëve të tjerë përgjatë muajit Qershor. Më pas ai së bashku me vëllain e tij Erdit Muça, kanë gjetur parcelen, kanë mbjellë fidanët e bimëve kanabis sativa dhe kanë vazhduar me proceset e tjera të kultivimit të bilëve narkotike. Më pas nga hetimi rezulton e provuar se janë angazhuar rreth muajit qershor dhe dy vëllezërit Gjoshi, të cilët janë përkujdesur për parcelën tjetër me 50 bimë të tjera. Vetë i pandehuri Alfred Muça e ka pranuar faktin penal për të cilën ai akuzohet. Edhe

për të pandehurin Erdit Muça provohet tërësisht angazhimi i tij i plotë në veprën penale të “Kultivimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim. Për të pandehurin Lulzim Çullhai rezultojnë tërësisht e provuar pjesmarrja e tij në këtë aktivitet kriminal të “Kultivimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, nëpërmjet sigurimit të fidanëve të bimëve kanabis sativa në sasinë prej 110 copë dhe më pas interesimin e tij për gjëndjen e bimëve dhe ecurinë e rritjes së tyre.

Fakti penal në ngarkim të të pandehurit provohet përmes procesverbaleve të transkriptimit të përgjimeve, procesverbaleve të marrjes së të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi si dhe përmes akteve të ekspertimit teknik kompjuterik nr.212 datë 06.12.2021, nr.215 datë 07.12.2021 si dhe provave të tjera të administruara në fashikullin penal. Për të pandehurin Kadri Gjoshi provohet tërësisht angazhimi i tij në veprën penale të “Kultivimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim. Vetë i pandehuri Kadri Gjoshi e ka pranuar faktin penal që i është komunikuar. Nga ana tjetër Kadri Gjoshi ka deklaruar se ka qenë Alfred Muça ai që i ka kërkuar angazhimin dhe dhënien e ndihmës për kultivimin e bimëve dhe përkundrejt kësaj ndihme, ai do të merrte shumën prej 1000 euro.

Per sa i perket te pandehurit Gerti Gjoshi, ai fillimisht nuk e ka pranuar akuzën, në momentin e arrestimit, por më pas e ka pranuar faktin penal dhe ka pranuar se ka shkuar për të ndihmuar vëllain e tij Kadri Gjoshi vetëm dy herë në vaditjen e bimëve narkotike. Fakti penal në ngarkim të tij provohet si me procesverbalet e transkriptimit të përgjimeve, procesverbaleve të marrjes së të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi si dhe përmes akteve të ekspertimit teknik kompjuterik nr.212 datë 06.12.2021, nr.215 datë 07.12.2021.

Lidhur me bashkëpunimin të parashikuar nga neni 25 i KP-së, sipas Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës Lartë që të konsiderohet vepra penale e kryer në bashkëpunim duhet të bashkëekzitojnë në mënyrë kumulative këto kushte: *“1. dy ose më shumë subjekte; 2. realizimi i faktit kriminal në të gjithë elementet e tij materiale; 3. dhënia e një kontributi rilevant në kryerjen e veprës penale nga secili prej bashkëpunëtorëve; 4. ana subjektive, të paktën në formën e saj minimale, që është dijenia e të paktën njërit prej bashkëpunëtorëve për të bashkëpunuar me të tjerët në kryerjen e faktit kriminal”*.¹ Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se vepra penale është kryer në bashkëpunim, në kushtet kur personat kane qenë në dijeni të faktit penal, si dhe kane bashkëpunuar me njeri tjetrin për mbledhje dhe perkujdesjen e rritjes se fidaneve te bimes narkotike cannabis sativa. Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se pavarësisht faktit se në këtë gjykim analizohen veprimet e të pandehureve Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi, Gerti Gjoshi, Lulzim Çullhai për të cilët provohet dhe pranohet fakti penal i “Kultivimit i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284, lidhur me bashkëpunimin gjykata analizon në kushtet kur vepra është kryer në bashkëpunim dhe në referim të vendimit unifikues nr.4, datë 15.04.2011 të Kolegjeve e Bashkuara të Gjykatës së Lartë përcaktohet se: *kur nga pikëpamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Kjo si për rastet 228 kur nuk identifikohen bashkëpunëtorët, ashtu edhe për rastet kur bashkëpunëtori nuk ka përgjegjësi penale për shkak të paaftësisë apo moshës për përgjegjësi penale. Cilësitë e veçanta që shtojnë, pakësojnë apo përjashtojnë dënimin merren parasysh vetëm për bashkëpunëtorin tek i cili ato ekzistojnë.*

Të pandehurit e sipërcituar janë subjekte të kësaj vepre penale pasi ata të gjithë kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale, pra, gjykata vlerëson se ata plotësojnë kriteret për të pasur përgjegjësi penale në këndvështrim të nenit 12/1 të KP dhe po ashtu rezultojnë me gjendje psikike të rregullt, duke qenë të përgjegjshëm përpara ligjit, kërkesë kjo e nenit 17 të KP.

Nga pikëpamja e anës subjektive vepra penale është kryer nga të pandehurit e mësipërm me faj në formën e dashjes së drejtëpërdrejtë, pasi të pandehuri ka parashikuar kundërligjshmërinë e veprimeve të tyre, si dhe pasojat e veprës dhe kanë dëshiruar ardhjen e tyre.

Kësisoj, Gjykata vlerëson se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se te pandehurit Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi, Gerti Gjoshi, Lulzim Çullhai e kanë kryer nga ana objektive veprën penale të “*Kultivimi i bimëve narkotike*” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 284 paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Ndërsa për të pandehurin Erdit Muça provohet se janë konsumuar edhe elementët e veprave penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga neni 278/3 dhe 278/4 të Kodit Penal.

Sipas dispozitës së mësipërme është parashikuar se:

“Mbajtja e armëve, e armëve shpërthyesë ose e lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet...”.

Gjykata, me qëllim zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, vlerëson të analizojë elementet e veprës penale të pretenduar dhe t'i ballafaqojë veprimet e kryera me elementët ligjore të parashikuar nga ligji penal.

Nga pikëpamja e objektit vepra penale e parashikuar nga neni 278 i KP (pra në formën e mbajtjes pa leje të armëve luftarake, municionit luftarak) cenojnë marrëdhëniet juridike të vendosura, të cilat garantojnë mbajtjen e armëve luftarake, municionit dhe lëndëve plasëse etj. sipas rregullave ligjore. Rregullime të tilla ligjore lidhen posaçërisht me ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, me sigurinë e jetës dhe shëndetit të njerëzve, të mbrojtura nga legjislacioni penal. Rezultoi se, në rastin konkret, provohet që ky objekt është cenuar nga i pandehuri, pasi me veprimet e tij të drejtëpërdrejta dhe të vullnetshme, veprime të cilat do t'i analizojmë më poshtë në analizë të anës objektive dhe subjektive të kësaj figure krimi.

Nga pikëpamja e anës objektive, Gjykata çmon të theksojë se, element të anës objektive të figurës së veprës penale janë: *i) veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm; ii) mënyra e kryerjes së veprës penale*, me të cilën kuptohet renditja e veprave, metodat e përdorura, karakteri kronologjik dhe specifika e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e veprës penale. Mënyra e kryerjes së veprës penale lidhet ngushtësisht me mjetet e përdorura nga personi për realizimin e saj; dhe *iii) Koha, vendi dhe ambjenti i kryerjes së veprës penale*, me të cilën kuptohet grumbullimi dhe unitetit i kushteve konkrete, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi kriminal,

në të cilat zhvillohet lidhja shkakësore dhe vjenë rezultati (pasoja) kriminale. Këto kushte ekzistojnë objektivisht dhe pavarësisht nga vullneti i subjektit i veprës penale.

Lidhur sa më sipër, Gjykata çmon të theksojë se, vepra penale e parashikuar nga neni 278 i KP kryhet nëpërmjet veprimeve, të cilat konsistojnë në mbajtjen e armës luftarake, mbajtjen e municionit luftarak dhe lëndëve plasëse. Nga ana objektive, rëndësi paraqet fakti që mbajtja bëhet pa leje të organeve kompetente shtetërore. Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se në nenin 278 të KP, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike të marrëdhënieve që garantojnë rendin dhe sigurinë publike, nga veprime të kundraligjshme e shoqërisht të rrezikshme e konkretisht nga mbajtja dhe përdorimi pa lejen e organeve kompetente të armëve luftarake, municioneve apo lëndëve plasëse. Neni 278 i KP në vetvete parashikon disa figura veprash penale. Mbajtja pa leje e municioneve dhe armës së zjarrit në banesë, aktualisht parashikohen si vepra penale në nenin 278/3 dhe 278/4 të KP. Duke përdorur fjalën “armë luftarake” në këtë dispozitë “blankete”, ligjvënësi të referon në nenin 1, gërma a) të ligjit nr.74/2014 “Për armët” sipas të cilit me anë të këtij ligji rregullohen kushtet dhe kriteret për mbajtjen, ruajtjen, tregtimin, importimin, eksportimin, gjurmimin e transportimin, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të armëve të kategorive "B", "C" e "D", sipas këtij ligji; si edhe gërma c) e po këtij neni, ku parashikohet se ky ligj rregullon marrëdhëniet për lëshimin e licencave dhe autorizimeve nga Policia e Shtetit për çdo subjekt të interesuar për veprimtaritë e lejuara me armë, sipas kategorive të përcaktuara në këtë ligj.

Kështu, përkufizimin e fjalës “armë zjarri” në kuptim të kësaj dispozite e gjejmë në nenin 3), pika 2), e ligjit si më sipër, sipas të cilit "armë zjarri" është çdo armë e transportueshme me tytë që realizon, është e projektuar për të realizuar ose mund të modifikohet lehtësisht për të realizuar të shtëna, plumba ose predha me anë të një lënde plasëse; dhe kërkon si kusht të domosdoshëm që personi, që mban këtë armë të mos jetë i autorizuar nga organet kompetente shtetërore, për të mbajtur të tilla sende. Veprimet e sipërcituara, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji duhet që: a) *Arma e zjarrit dhe municionet e armëve luftarake të mbajtura nga personi, të jenë teknikisht të aftë për të realizuar qitje;* b) *Vepra penale e parashikuar nga neni 278 i KP realizohet me mbajtjen e armëve të zjarrit dhe municionit luftarak, në kuptim të ligjit me nr.74/2014 “Për armët” dhe kërkon si kusht të domosdoshëm që personi, që mban këtë sende të kundraligjshme të mos jetë i autorizuar nga organet kompetente shtetërore, për të mbajtur të tilla armë zjarri apo municione luftarake.*

Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimi, Gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se, i pandehuri Erdit Muça ka kryer veprat penale “*Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, të parashikuara nga nenet 278/3 dhe 278/4 i Kodit Penal, pasi ky shtetas ka mbajtur armë luftarake pushkë gjysëm automatike luftarake e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm nr.KIO 1076, në afersi të banesës dhe 240 fishekëve standardë luftarakë të modelit 56 dhe kalibër 7.62mm, brenda në banesë dhe nuk ka qenë i autorizuar nga organet kompetente shtetërore për të mbajtur armë të tilla zjarri.

Konkretisht është administruar akti teknik armësh e fishekësh dhe balistik gëzhgojash Sipas aktit të ekspertimit teknik armësh dhe balistik nr.9079 datë 14.09.2021 ku është përcaktuar se: “*Arma e zjarrit objekt ekspertimi me nr.KIO 1076, sekuestruar pranë banesës së shtetasve Erdit dhe Alfred Muça, më datë 08.09.2021, është pushkë gjysëm automatike luftarake e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm. Arma është në gjëndje të rregullt teknike dhe realizon qitje normalisht.- Gëzhgojat e regjistruara në sistemin ARSENAL nuk u identifikuan të qitura nga arma e zjarrit pushkë model 56, me nr.KIO 1076.-240 fishekët objekt ekspertimi janë fishekë standardë luftarakë të modelit 56 dhe kalibër 7.62mm, që përdoren si municion për pushkët e modelit 56*

dhe 63..... *Fishekët janë në gjëndje të rregullt teknike dhe të përshtatshëm për qitje.*” Sikurse rezultoi e provuar në çështjen objekt gjykimi, i pandehuri Erdit Muça nuk është i autorizuar nga organet kompetente shtetërore për mbajtur armë zjarri.

Po kështu, për të pandehurin Kadri Gjoshi provohet se janë konsumuar edhe elementët e vepres penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal.

Gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se, i pandehuri Kadri Gjoshi ka kryer veprën penale “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, pasi ky shtetas ka mbajtur një armë zjarri luftarake automatik e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm, në banesë dhe nuk ka qenë i autorizuar nga organet kompetente shtetërore për të mbajtur armë të tilla zjarri. Konkretisht është administruar akti teknik armësh e fishekësh dhe balistik gëzhgojash nr.9363 datë 20.09.2021 ku është përcaktuar se: “-Arma e zjarrit objekt ekspertimi me nr.11119745, sekuestruar në banesën e shtetasve Gert Gjoshi dhe Halil Gjoshi, më datë 08.09.2021, është armë zjarri luftarake automatik e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm. Arma është në gjëndje të rregullt teknike dhe realizon qitje normalisht.-Gëzhgojat e regjistruara në sistemin ARSENAL nuk u identifikuan të qitura nga arma e zjarrit me nr. 11119745.-45 fishekët objekt ekspertimi janë fishekë standardë luftarakë të modelit 56 dhe kalibër 7.62mm, që përdoren si municion për pushkët e modelit 56 dhe 63. Fishekët janë në gjëndje të rregullt teknike dhe të përshtatshëm për qitje.” Sikurse rezultoi e provuar në çështjen objekt gjykimi, i pandehuri Kadri Gjoshi nuk është i autorizuar nga organet kompetente shtetërore për mbajtur armë zjarri.

Per sa i perket te pandehurit Dashamir Hasanaj, gjykata çmon se nga i pandehuri janë konsumuar elementët e veprave penale “Moskallezim Krimi”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga nenet 300, 278/4 dhe 280 te Kodit Penal.

Gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se, i pandehuri Dashamir Hasanaj ka kryer veprën penale “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, pasi ky shtetas ka mbajtur një armë zjarri luftarake pushkë e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm, në banesë dhe nuk ka qenë i autorizuar nga organet kompetente shtetërore për të mbajtur armë të tilla zjarri. Konkretisht është administruar akti teknik armësh e fishekësh dhe balistik gëzhgojash nr.9995 datë 01.10.2021 ku është përcaktuar se: “-Arma e zjarrit objekt ekspertimi me nr.H4283, sekuestruar në banesën e shtetasit Dashamir Hasanaj, më datë 08.09.2021, është armë zjarri luftarake pushkë e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm. Arma është në gjëndje të rregullt teknike dhe realizon qitje normalisht...” Sikurse rezultoi e provuar në çështjen objekt gjykimi, i pandehuri Dashamir Hasanaj nuk është i autorizuar nga organet kompetente shtetërore për mbajtur armë zjarri. Gjykata konkludon në lidhje me këtë element të vepres penale (pra në anën objektive) parashikuar nga paragrafi i katërt, pra në mbajtjen e armës luftarake në banesë, parashikuar përkatësisht nga neni 278/4 të Kodit Penal.

Njekohesisht gjykata çmon se veprimet e të pandehurit Dashamir Hasanaj plotësojnë të gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t’i cilësuar si elementë të figurës së veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, të parashikuar nga neni 280 i K. Penal. Sipas dispozitës së cituar: “Prodhimi, mbajtja, shitja ose blerja e armëve të gjuetisë ose sportive, si dhe e municioneve të tyre, pa leje të organeve kompetente shtetërore, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.”.

Në kuptim të dispozitës së mësipërme, rezulton se objekt i figurës së veprës penale të *“Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive”*, janë veprimet e kundërligjshme të mbajtjes nga i pandehuri të një arme zjarri gjuetie pa lejen e organeve kompetente, duke cenuar në këtë mënyrë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, të jetës së shtetasve nga prodhimi apo mbajtja pa leje e armeve të zjarrit (të gjuetisë apo sportive), të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal, duke konsumuar kështu veprën penale të parashikuar nga neni 280 i K. Penal.

Nga ana objektive, i pandehuri Dashamir Hasanaj ka konsumuar veprën penale që i atribuohet me veprime aktive të kundërligjshme, veprime këto që konsistojnë në marrjen dhe mbajtjen prej tij të një arme zjarri gjuetie me një tytë, e kalibrit 12mm pa lejen e organeve kompetente shtetërore. Sipas Aktit të Ekspertimit Tekniko-Balistik nr.9995 datë 01.10.2021 ku është përcaktuar se: *“...Arma e gjahut objekt ekspertimi me nr.AH77630, kalsifikohet si armë zjarri gjuetie me një tytë, e kkalibrit 12mm dhe në gjëndjen që paraqitet është e rregullt teknikisht dhe e përshtatshme për qitje”*.Sa më lart, në kushtet kur provohet se arma e gjahut e poseduar nga i pandehuri ka qenë në gjendje të rregullt teknike dhe e përshtatshme për qitje, konkludohet se ai ka konsumuar plotësisht elementët e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 280 i K. Penal.

Gjithashtu nga tërësia e fakteve të mësipërme, provohet qartë se i pandehuri Dashamir Hasanaj ka konsumuar elementët e veprës penale *“Moskallëzim krimi”* parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Nga veprimet dhe mosveprimet kriminale të tyre janë cënuar cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar funksionimin e rregullt të organeve të drejtësisë të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal. Për shkak të moskallëzimit të krimit lihet shteg zhvillimit të kriminalitetit , mbeten padënuar personat fajtorë, duke u cënuar kështu autoriteti i organeve të drejtësisë dhe interesat shtetërore e shoqërore në tërësi.

Nga ana objektive krimi i moskallëzimit realizohet nëpërmjet mosveprimit të kundërligjshëm, pasi edhe pse personi detyrohet me ligj të bëjë kallëzimin për një krim që është kryer apo është duke u kryer dhe nuk e bën atë. Referuar rrethanave të faktit të mësipërm lidhur me akuzën e të pandehurit për veprën penale *“Moskallëzimi i krimit”* parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, gjykata konkludon se ai nga ana objektive me mosveprime ka konsumuar elementët e kësaj vepre penale, pasi rezultoi tërësisht e provuar se ky shtetas ka pasur dijeni të plotë për veprimtarinë kriminale të kryer nga shtetasit Lulzim Çullhai, Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi dhe Gert Gjoshi dhe nuk ka njoftuar organet e policisë për këtë fakt kriminal.

Ndërsa për të pandehurën Xhevrije Muça provohet se janë konsumuar elementët e veprës penale *“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”* parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal.

Gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se, i pandehura Xhevrije Muça ka kryer veprën penale *“Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”*, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, pasi kjo shtetase ka mbajtur një armë zjarri Zastava e modelit 56 dhe kalibër 6.35 mm, në banesë dhe nuk ka qenë e autorizuar nga organet kompetente shtetërore për të mbajtur armë të tilla zjarri. Konkretisht është administruar akti teknik armësh e fishekësh dhe balistik gëzhgojash nr.9364 datë 20.09.2021 ku është përcaktuar se: *“Arma e zjarrit objekt ekspertimi, sekuestruar në banesën e shtetasës Xhevrije Muça, është armë pistolete zastava e modelit 56 dhe kalibër 6.35mm. Arma është në gjëndje të*

rregullt teknike dhe realizon qitje normalisht.” Sikurse rezultoi e provuar në çështjen objekt gjykimi, e pandehura Xhevrije Muça nuk është e autorizuar nga organet kompetente shtetërore për mbajtje armë zjarri. Gjykata konkludon në lidhje me këtë element të veprës penale (pra në anën objektive) parashikuar nga paragrafi i katërt, pra në mbajtjen e armës luftarke parashikuar përkatësisht nga neni 278/4 të Kodit Penal.

Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale të “Kultivimit të bimeve narkotike” “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, dhe “Moskallezim Krimi”, parashikuar nga nenet 284/2, 278/4, 280 e 300 të Kodit Penal. Konkretisht në nenin 14 të Kodit Penal thuhet se: *“Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si veprë penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.”* Këto forma të zbatimit të parimit të fajësisë në të drejtën penale përbëjnë edhe qëndrimin psikologjik apo subjektiv që shfaq autori ndaj veprës penale dhe nuk mund të atribuohet veprimi kriminal në mënyrë objektive apo absolute pa pasur një lidhje psikologjike me anën objektive të veprës penale.

Gjykata vlerëson se, figura e këtyre veprës penale kërkojnë si formë faji dashjen e drejtëpërdrejtë. Gjithashtu, gjykata vlerëson se, ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarin kriminal gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Prandaj, për të përcaktuar anën subjektive në çështjen objekt gjykimi, gjykata do të analizojë veprimet e të pandehurit. Kështu, në plotësim të këtij elementi gjykata çmon se të pandehurit kanë vepruar me dashje të drejtëpërdrejtë, pasi ata kanë parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tyre dhe kanë vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme.

Në lidhje me subjektet e veprës penale të mësipërme, gjykata vlerëson se në rastin konkret plotësohet ky element, duke pasur parasysh nenin 12 të Kodit Penal, ku thuhet se *“Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç”*. Kështu, personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (*condicio sine qua non*): *i*) Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe *ii*) të jetë i përgjegjshëm.

Në kuptim të subjektit të veprës penale personi duhet të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret, të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qënë mbi 18 vjeç dhe rrjedhimisht gjykata, në vështrim të nenit 12/1 të Kodit Penal, çmon se në drejtim të moshës të pandehureve ata kanë qënë dhe janë të përgjegjshëm penalisht dhe si tillë ata kanë moshën për përgjegjësi penale para ligjit.

Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi nuk u provua që të pandehurit të vuajnë nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tyre mendor dhe për pasojë nuk kanë qënë në gjendje të kontrollojnë veprimet apo mosveprimet e tyre dhe as të kuptojnë se kryejnë veprë penale. Përkundrazi me veprimet e tyre provohet që ata kanë qënë të aftë të posedojnë aftësi intelektuale dhe volutive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tyre dhe t’u kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se të pandehurit Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi, Gerti Gjoshi, Lulzim Çullhai, Dashamir Hasanaj, Xhevrije Muça janë subjekte të përgjegjshme penalisht.

Sa më sipër u arsyetua, gjykata vlerëson se mbi bazën e provave të administruara rezulton se ka prova të mjaftueshme që provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se të pandehurit Alfred Muça, Erdit Muça, Kadri Gjoshi, Gerti Gjoshi, Lulzim Çullhai, Dashmir Hasanaj, Xhevrije Muça, i kanë konsumuar figurat e veprave penale për të cilat akuzohen dhe duhet të deklarohen fajtorë sipas ligjit.

Lidhur me llojin dhe masat e dënimit që duhet të caktohen ndaj secilit prej të pandehurve, gjykata duhet të marrë në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, mënyrën, mekanizimin dhe formën e kryerjes së veprave penale. Gjithashtu gjykata bazuar në nenet 47, 48, 49, të Kodit Penal merr parasysh, shkallën dhe formën e fajit të të pandehurve kryerjen e veprës penale me (dashje të drejtëpërdrejtë).

Në lidhje me rrezikshmërinë e figurës së veprës penale “Kultivimi i bimeve narkotike”. Përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet gjithmonë me natyrën dhe llojin e saj, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen, pasojat që ka sjellë. Gjukata thekson se kjo vepër përbën krim dhe paraqet rrezikshmëri relativisht të lartë shoqërore, për të cilën ligjvënësi parashikon denimet e përshkruara më lart. Rrezikshmëria shoqërore e kësaj vepre, në kushtet aktuale është e lartë duke parë tendecat e rritjes së kësaj vepre penale, jo vetëm në gjithë territorin e Republikën së Shqipërisë, por edhe përhapjen e kësaj vepre penale në rrethin e Tiranës. Prandaj, në caktimin e dënimit gjykata duhet të ketë parasysh që në dënimin ndaj tyre gjykata të marrë parasysh funksionin e parandalimit të përgjithshëm në kryerjen e kësaj vepre penale.

Lidhur me të pandehurin Erdit Muça ne kushtet kur provohet fajësia gjykata lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin , bazohet në nenet 47, 48, 49 të K. Penal. Për sa i përket masës së dënimit, gjykata mban parasysh: Rrezikshmërinë shoqërore të lartë të veprës penale dhe të autorit të saj, e shprehur në mënyrën e kryerjes së veprës penale, faktin që vepra penale është kryer në rrethana cilësuese (bashkëpunim). Gjithashtu, duke mbajtur parasysh edhe marzhin e dënimit të saj, rrethanat e kryerjes së saj në bashkëpunim, sasinë relativisht të madhe të bimëve narkotike të cilat janë mbjelle. Rrethanat lehtësuese, ku në rastin konkret i pandehuri tregoi në gjykim pendim të thellë, fakt i cili përbën rrethanë lehtësuese parashikuar nga neni 48/ç të K. Penal, formën e fajit, i pandehuri e ka kryer veprën me dashje direkte. Gjukata merr parasysh rrethanat familjare tw tij. Faktin që i pandehuri nuk është përsëritës, pra i padënuar më parë dhe në gjykim ai kerkoj meshire. Ndërsa mbajtja pa leje në banesë të armës luftarake pushkë gjysëm automatike luftarake e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm nr.KIO 1076, si dhe me mbajtjen e 240 fishekëve standardë luftarakë të modelit 56 dhe kalibër 7.62mm, brenda në banesë, tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të lartë të tij. Formën e fajit, ku rezulton se ai ka kryer veprat penale me dashje direkte.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet ndaj të pandehurit, gjykata çmon se ajo duhet të jetë në përputhje më tërësinë e rrethanave të ngjarjes, mekanizimit të saj, rrethanave lehtësuese e rënduese, të cilat në tërësinë e tyre përlligjin dënimin e tij me burgim.

Gjukata çmon se i pandehuri duhet dënuar me 5 (pese) vjet burgim për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimeve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal. Ndërsa për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal e dënon me 6(gjashtë) muaj burgim, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal e dënon me 1(nje) vit burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit, me 5 (pesë) vjet e 6 (gjashte) muaj burgim. Ndaj

të pandehurit zbatohet nenit 406/1 i Kodit të Procedurës Penale, duke u ulur dënimi në 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 3(tre) vjet e 8(tete) muaj burgim.

Gjykata çmon se nuk jemi në kushtet e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, sipas parashtrimit të mbrojtjes. Kjo nisur nga tërësia e rrethanave të mësipërme, ku rezulton që janë konsumuar disa vepra penale, nga të cilat vepra penale me shkallë rrezikshmërie më të lartë është ajo e parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe që parashikon një dënim në minimum 5 vjet burgim, cili nga gjykata çmon se duhet të përthithet në një farë masë edhe dënimet e tjera, duke marrë në konsideratë veprat penale të parashikuara nga nenet 278/3/4 të Kodit Penal janë kryer nga ana objektive duke u mbajtur sendet e paligjshme armë zjarri, dhe municione në banesën e tij dhe ato nuk janë përdorur prej tij, pra nuk ka ardhur asnjë pasojë.

Aplikimi i këtij dënimi për të pandehurin është në përputhje të plotë me rëndësinë e faktit, rrethanat e kryerjes së veprave penale dhe realizon plotësisht qëllimin kompleks të dënimit penal për ndëshkimin, riedukimin e tyre dhe parandalimin e përhapjes së këtyre veprave penale në shoqërinë tonë.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin fillon nga dita e ndalimit datë 08.09.2021 dhe në zbatim të nenit 18 të Ligjit 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, vuajtja e dënimit të kryhet nga i pandehuri në një burg të sigurisë së zakonshme.

Lidhur me të pandehurin Kadri Gjoshi ne kushtet kur provohet fajësia gjykata lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin , bazohet në nenet 47, 48, 49 të K. Penal. Për sa i përket masës së dënimit, gjykata mban parasysh: Rrezikshmërinë shoqërore të lartë të veprës penale dhe të autorit të saj, e shprehur në mënyrën e kryerjes së veprës penale, faktin që vepra penale është kryer në rrethana cilësuese (bashkëpunim). Gjithashtu, duke mbajtur parasysh edhe marzhin e dënimit të saj, rrethanat e kryerjes së saj në bashkëpunim, sasinë relativisht të madhe të bimëve narkotike të cilat janë mbjelle. Rrethanat lehtësuese, ku në rastin konkret i pandehuri tregoi në gjykim pendim të thellë, fakt i cili përbën rrethanë lehtësuese parashikuar nga neni 48/ç të K. Penal, formën e fajit, i pandehuri e ka kryer veprën me dashje direkte. Gjykata merr parasysh rrethanat familjare, i cili është kryefamiljar me 1 fëmijë të mitur (3 vjec).Faktin se i pandehuri Kadri Gjoshi ka mbajtur qëndrim pohues në lidhje me fajësinë që në fillim dhe madje ka treguar se si është angazhuar ai në këtë veprimtari kriminale duke dhënë detaje të rëndësishme për organin procedues. Po kështu nga hetimi i kryer ka rezultuar një përfshirje në vadijen e bimëve narkotike, si dhe faktin që ka terhequr vëllain e tij Gerti Gjoshi në krim.Faktin që i pandehuri nuk është përsëritës, pra i padënuar më parë dhe në gjykim ai kërkoj meshire. Po kështu nga ana e tij është konsumuar edhe vepra penale mbajtja pa leje të armës luftarake automatik e modelit 56 dhe kalibër 7.62mm në banesën e tij.Formën e fajit, ku rezulton se ai ka kryer veprat penale me dashje direkte.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet ndaj të pandehurit, gjykata çmon se ajo duhet të jetë në përputhje me tërësinë e rrethanave të ngjarjes, mekanizimit të saj, rrethanave lehtësuese e rënduese, të cilat në tërësinë e tyre përligjin dënimin e tij me burgim.

Gjykata çmon se i pandehuri duhet dënuar me 5 (pese) vjet burgim për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimeve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.Ndërsa për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”

parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal e dënon me 1(nje) vit burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit, me 5 (pesë) vjet burgim. Ndaj të pandehurit zbatohet neni 406/1 i Kodit të Procedurës Penale, duke u ulur dënimi në 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 3(tre) vjet e 4(kater) muaj burgim.

Gjykata çmon se nuk jemi në kushtet e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, sipas parashtrimit të prokurores, si dhe kërkesës së mbrojtjes. Kjo nisur nga tërësia e rrethanave të mësipërme, ku rezulton që janë konsumuar dy vepra penale, nga të cilat vepra penale me shkallë rrezikshmërie më të lartë është ajo e parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe që parashikon një dënim në minimum 5 vjet burgim, cili nga gjykata çmon se duhet të përthithe edhe dënimin tjetër, duke marrë në konsideratë veprën penale të parashikuara nga neni 278/4 të Kodit Penal janë kryer nga ana objektive duke u mbajtur sendet e paligjshme armë zjarri, në banesën e tij dhe ato nuk janë përdorur prej tij, pra nuk ka ardhur asnjë pasojë.

Ky kërkim nuk u pranua nga gjykata, për arsye se: Në interpretim logjik e literal të nenit 59 të KP, si dhe bazuar në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, Gjykata thekson se zbatimi i nenit 59 të KP është në diskrecion të gjykatës, e cila nëse çmon se plotësohet një ose disa nga kushtet e parashikuara nga kjo dispozitë vendos aplikimin e saj. Nga ana tjetër, në mënyrë që të aplikohet kjo dispozitë nga gjykata, duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet si më poshtë vijon:

Së pari: Të ekzistojë një prej kushteve të renditur në pjesën e parë të paragrafit të parë të kësaj dispozite si rrezikshmëria e pakët e personit, autorit të veprës, mosha e të gjykuarit, kushtet shëndetësore apo mendore të tij, mënyra e jetesës dhe nevojat që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, të cilët janë kushte alternativë jo kumulative. Pra, mjafton të evidentohet se ekziston njëri prej tyre sëbashku me kushtin tjetër, të poshtërenditur;

Së dyti: Gjykata të ketë dhënë ndaj të pandehurit, në përfundim të gjykimit, një dënim jo më të lartë se pesë vjet burgim. Pra, ligjvënësi e ka lidhur zbatimin e nenit 59 me masën e dënimit të dhënë nga gjykata (kur jep dënim me burg deri në pesë vjet) dhe jo me atë të parashikuar nga dispozita konkrete e pjesës së posaçme të Kodit Penal për të cilën është deklaruar fajtor i pandehuri. Edhe pse në rastin konkret gjykata ka dhënë dënim 5 vite burgim, por me gjykim të shkurtuar është dënuar përfundimisht 3vjet e 4 muaj, gjykata vlerësoi të analizojë arsyet dhe shkaqet se përse nuk mund të aplikohet neni 59.

Në vijim të analizës së mësipërme juridike arrihet në konkluzionin se, në mënyrë që të aplikohet në çdo rast konkret neni 59 i KP, duhet të evidentohet ekzistenca e njërit prej kushteve alternativ të renditur në pjesën e parë të fjalisë së parë të këtij neni dhe gjykata të ketë caktuar një dënim deri në pesë vjet burgim.

Pezullimi i ekzekutimit me kusht zbatimin e provës, synon parandalimin e kryerjes së veprave penale, duke shmangur nga ekzekutimi i dënimit, personat e dënuar si fajtorë, të cilët paraqesin mundësinë e korigjimit, integritet, përmirësimit e të ndërrimit të sjelljes së tyre nën sanksionin e rikthimit të ekzekutimit të vendimit të dënimit, nëpërmjet revokimit të këtij përfitimi, kur mungon respektimi i kushteve mbi të cilat ai ishte akorduar.

Sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: “... për të aplikuar në mënyrë sa më të drejtë nenin 59 të Kodit Penal, gjykata e themelit gjatë shqyrtimit gjyqësor ka për detyrë të identifikojë rrethanën e posaçme që ekziston në rastin dhe çështjen e të gjykuarit dhe arsyetimin e mjaftueshëm lidhur me këtë aspekt për zbatimin e ligjit penal material. (...) Bindje, e cila nuk mund të mjaftohet vetëm me përmendjen e rrethanave të parashikuara si lehtësuese për caktimin e dënimit. Këto të fundit kanë si qëllim caktimin e masës së dënimit në mënyrë sa më të përshtatshme me kushtet personale të të pandehurit, të cilat me të drejtë gjykata i ka marrë në konsideratë në parametrizimin e masës së dënimit, ndërsa instituti i pezullimit të ekzekutimit të dënimit, ka tjetër qëllim. Qëllimi i tij, mbasi është kryer vlerësimi në këndvështrimin parashikues, është ai i moskryerjes të veprave penale në të ardhmen nga ana e të dënuarit dhe ky aspekt, duhet të ishte përmendur në arsyetimin e gjykatave të themelit.”

Në çështjen në shqyrtim përpara kësaj gjykate, për të pandehurin Kadri Gjoshi ekzistojnë rrethana si, fakti që ai nuk ka konsumuar vetëm një vepër penale, por dy vepra të cilat paraqesin rrezikshëri shoqërore, gjë që tregojnë një shkallë rrezikshmërie me të lartë të tij, pasi ai ka përfshirë duke ndikuar dhe implikuar në këtë vepër penale edhe vëllanë e tij, i pandehur në këtë proces(ndihmuar në dy episode në vadijen e lëndës narkotike të kultivuar).

Nga ana tjetër, pavarësisht pretendimeve të ngritura nga i pandehuri, është në diskrecion të gjykatës të vendosë aplikimin ose jo të kësaj dispozite e cila literalisht parashikon: “...**gjykata**, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, **mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.**”

Gjykata konkludon se duke patur parasysh vetë qëllimin e nenit 59 të KP, aplikimi i të cilit lidhet pikërisht me qëllimin riedukues të dënimit penal, i cili në disa raste çmohet se realizohet pa qenë e nevojshme që individi të izolohet nga shoqëria, por që në rastin konkret nuk konsiderohet i tillë nga gjykata.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin fillon nga dita e ndalimit datë 08.09.2021 dhe në zbatim të nenit 18 të Ligjit 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, vuajtja e dënimit të kryhet nga i pandehuri në një burg të sigurisë së zakonshme.

Lidhur me të pandehurin Alfred Muça lloji i dënimit me burgim dhe masa e tij çmohet duke marrë në vlerësim: Rrezikshmërinë shoqërore të lartë të veprës penale dhe të autorit të saj, e shprehur në mënyrën e kryerjes së veprës penale, faktin që vepra penale është kryer në rrethana cilësuese (bashkëpunim). Gjithashtu, duke mbajtur parasysh edhe marzhin e dënimit të saj, rrethanat e kryerjes së saj në bashkëpunim, sasinë relativisht të madhe të bimëve narkotike të cilat janë mbjelle. Rrethanat lehtësuese, ku në rastin konkret i pandehuri tregoi në gjykim pendim të thellë, fakt i cili përbën rrethanë lehtësuese parashikuar nga neni 48/ç të K. Penal, formën e fajit, i pandehuri e ka kryer veprën me dashje direkte. Gjykata merr parasysh rrethanat familjare ku i pandehuri jeton me dy prindërit, gjyshen, vëllezërit dhe motrën (sipas certifikatës familjare datë 14.09.2021 lëshuar nga Zyra e Gjëndjes Civile Petrelë) dhe janë në gjëndje të vështirë ekonomike. Faktin që i pandehuri nuk është përsëritës, pra i padënuar më parë dhe në gjykim ai kerkoj meshire. Nga ana tjetër jemi në kushtet e një veprës penale me një shkallë rrezikshmërie të lartë, për të cilën dispozita penale parashikon një dënim me burgim në minimum nga pese deri në dhjetë vjet.Po kështu gjykata merr parasysh faktin se në kushtet e

kësaj familjeje ai është së bashku me vëllanë e tij i arrestuar, pra, nisur nga parimi i humanizmit duhet mbajtur në mënyrë specifike ky fakt për të mundësuar lirin e tij, për të shërbyer në lehtësimin e rrethanave të vështira ekonomike familjare.

Gjykata lidhur me masën e dënimit çmon se masa e kërkuar nga prokurori është në përputhje më tërësinë e rrethanave lehtësuese të evidentuara më sipër. Në rastin konkret duke pasur parasysh rrezikshmërinë e ulët të të pandehurit, gjykata çmon se ndaj tij duhet aplikuar alternativa e pezullimit të dënimit me burgim dhe vënies në provë, bazuar në nenin 59 të Kodit Penal, për pjesën e dënimit të mbetur. I pandehuri Alfred Muça i plotëson kushtet për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë, ndaj gjykata vlerëson së duhet aplikuar dënimi alternativ duke çmuar se në rastin konkret plotësohen tërësisht kërkesat ligjore për zbatimin e nenit 59 të Kodit Penal, ndaj të pandehurit në vlerësim të rrethanave lehtësuese të sipërcituara. Kjo alternativë e dënimit në një vlerësim të hollësishëm të rrethanave të mësipërme të çështjes të analizuar, çmohet nga gjykata se do të realizojë njëkohësisht jo vetëm qëllimin e ndëshkimit të të pandehurit për veprën penale të kryer, por edhe atë të rehabilitimit, edukimit dhe riintegritimit të tij në të ardhmen në shoqëri, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Në këto kushte ai duhet dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 284/2 me 5 (pese) vjet burgim. Ndaj të pandehurit zbatohet neni 406/1 i Kodit të Procedurës Penale, duke u ulur dënimi në 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 3 (tre) vjet burgim. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit (për pjesën e mbetur) me burgim ndaj të pandehurit Alfred Selman Muça, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe 3 (tre) vjet.

Në zbatim të nenit 389 të K.Pr.Penale deklarohet heqja e masës së sigurimit “Arrest ne burg”, caktuar ndaj të pandehurit me vendimin Nr.1562 akti, dt.12.09.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Lidhur me të pandehurin Lulzim Çullhai lloji i dënimit me burgim dhe masa e tij çmohet duke marrë në vlerësim: Rrezikshmërinë shoqërore të lartë të veprës penale dhe të autorit të saj, e shprehur në mënyrën e kryerjes së veprës penale, faktin që vepra penale është kryer në rrethana cilësuese (bashkëpunim). Gjithashtu, duke mbajtur parasysh edhe marzhin e dënimit të saj, rrethanat e kryerjes së saj në bashkëpunim, sasinë relativisht të madhe të bimëve narkotike të cilat janë mbjelle. Rrethanat lehtësuese, ku në rastin konkret i pandehuri tregoi në gjykim pendim të thellë, fakt i cili përbën rrethanë lehtësuese parashikuar nga neni 48/ç të K. Penal, formën e fajit, i pandehuri e ka kryer veprën me dashje direkte. Gjykata merr parasysh rrethanat familjare ku i pandehuri është kryefamiljar (me dy fëmijë, sipas certifikatës familjare lëshuar nga Zyra e Njësisë Administrative Nr.2). Përpos kësaj nga aktet e administruara rezulton se i pandehuri Lulzim Çullhai vuan nga një sëmundje e rëndë që sipas aktit të ekspertimit mjek-ligjor nr. 78 datë 17.01.2022 është diagnostifikuar me anemi hemolitike autoimmune e thellë, diabet mellitus insulinovartes në shifra të pastabilizuara dhe hipertension arterial. Po kështu në konkluzion të këtij akti ekspertimi është theksuar se në stadin në të cilën ndodhen sëmundjet ato nuk mund të kurohen në kushtet e paraburgimit. Faktin që i pandehuri nuk është përsëritës, pra i padënuar më parë dhe në gjykim ai kerkoi meshire. Nga ana tjetër jemi në kushtet e një vepre penale me një shkallë rrezikshmërie të lartë, për të cilën dispozita penale parashikon një dënim me burgim në minimum nga pese deri në dhjetë vjet.

Gjykata lidhur me masën e dënimit çmon se masa e kërkuar nga prokurori është në përputhje më tërësinë e rrethanave lehtësuese të evidentuara më sipër. Në rastin konkret duke

pasur parasysh rrezikshmërinë e ulët të të pandehurit, gjykata çmon se ndaj tij duhet aplikuar alternativa e pezullimit të dënimit me burgim dhe vënies në provë, bazuar në nenin 59 të Kodit Penal, për pjesën e dënimit të mbetur. I pandehuri Lulzim Çullhai i plotëson kushtet për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë, ndaj gjykata vlerëson se duhet aplikuar dënimi alternativ duke çmuar se në rastin konkret plotësohen tërësisht kërkesat ligjore për zbatimin e nenit 59 të Kodit Penal, ndaj të pandehurit në vlerësim të rrethanave lehtësuese të sipërcituara. Kjo alternativë e dënimit në një vlerësim të hollësishëm të rrethanave të mësipërme të çështjes të analizuara, çmohet nga gjykata se do të realizojë njëkohësisht jo vetëm qëllimin e ndëshkimit të të pandehurit për veprën penale të kryer, por edhe atë të rehabilitimit, edukimit dhe riintegritimit të tij në të ardhmen në shoqëri, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Në këto kushte ai duhet dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 284/2 me 5 (pese) vjet burgim. Ndaj të pandehurit zbatohet neni 406/1 i Kodit të Procedurës Penale, duke u ulur dënimi në 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 3(tre) vjet burgim. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit (per pjesen e mbetur) me burgim ndaj të pandehurit Lulzim Çullhai, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe 3 (tre) vjet.

Në zbatim të nenit 389 të K.Pr.Penale deklarohet heqja e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur ne policine gjyqesore”, caktuar ndaj të pandehurit me vendimin Nr.1562/1 akti, dt.18.01.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Lidhur me të pandehurin Gerti Gjoshi lloji i dënimit me burgim dhe masa e tij çmohet duke marrë në vlerësim: Rrezikshmërinë shoqërore të lartë të veprës penale dhe të autorit të saj, e shprehur në mënyrën e kryerjes së veprës penale, faktin që vepra penale është kryer në rrethana cilësuese (bashkëpunim). Gjithashtu, duke mbajtur parasysh edhe marzhin e dënimit të saj, rrethanat e kryerjes së saj në bashkëpunim, sasinë relativisht të madhe të bimëve narkotike të cilat janë mbjelle. Rrethanat lehtësuese, ku në rastin konkret i pandehuri tregoi në gjykim pendim të thellë, fakt i cili përbën rrethanë lehtësuese parashikuar nga neni 48/ç të K. Penal, formën e fajit, i pandehuri e ka kryer veprën me dashje direkte. Faktin se I pandehuri Gerti Gjoshi ka mbajtur fillimisht qëndrim mohues në lidhje me fajësinë dhe më pas e ka pranuar atë. Megjithatë nga hetimi I kryer ka rezultuar një përfshirje vetëm ne disa episode për vaditjen e bimëve narkotike dhe jo një angazhim I plotë sic ka rezultuar për të pandehurit e tjerë. Gjukata merr parasysh rrethanat familjare ku i pandehuri është kryefamiljar, me 3 fëmijë të mitur (13, 10 dhe 7 vjeç). Përpos kësaj nga aktet e administruara rezulton se I pandehuri Lulzim Çullhai vuan nga një sëmundje e rëndë që sipas aktit të ekspertimit mjek-ligjor nr. 78 datë 17.01.2022 është diagnostifikuar me anemi hemolitike autoimmune e thellë, diabet mellitus insulinovartes në shifra të pastabilizuara dhe hipertension arterial. Po kështu në konkluzion të këtij akti ekspertimi është theksuar se në stadin në të cilën ndodhen sëmundjet ato nuk mund të kurohen në kushtet e paraburgimit. Faktin që i pandehuri nuk është përsëritës, pra i padënuar më parë dhe në gjykim ai kerkoi meshire. Nga ana tjetër jemi në kushtet e një vepre penale me një shkallë rrezikshmërie të lartë, për të cilën dispozita penale parashikon një dënim me burgim në minimum nga pese deri në dhjetë vjet.

Gjukata lidhur me masën e dënimit çmon se masa e kërkuar nga prokurori është në përputhje më tërësinë e rrethanave lehtësuese të evidentuara më sipër. Në rastin konkret duke pasur parasysh rrezikshmërinë e ulët të të pandehurit, gjykata çmon se ndaj tij duhet aplikuar alternativa e pezullimit të dënimit me burgim dhe vënies në provë, bazuar në nenin 59 të Kodit

Penal, për pjesën e dënimit të mbetur. I pandehuri Gerti Gjoshi i plotëson kushtet për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë, kjo referuar edhe rrethanave familjare ku janë dy vëllezër të arrestuar, por që përfshirja e tij është vetëm në dy episode dhe që është përfshirë në këtë aktivitet nga i vëllai, ndaj gjykata vlerëson se duhet aplikuar dënimi alternativ duke çmuar se në rastin konkret plotësohen tërësisht kërkesat ligjore për zbatimin e nenit 59 të Kodit Penal, ndaj të pandehurit në vlerësim të rrethanave lehtësuese të sipërcituara. Kjo alternativë e dënimit në një vlerësim të hollësishëm të rrethanave të mësipërme të çështjes të analizuar, çmohet nga gjykata se do të realizojë njëkohësisht jo vetëm qëllimin e ndëshkimit të pandehurit për veprën penale të kryer, por edhe atë të rehabilitimit, edukimit dhe riintegritimit të tij në të ardhmen në shoqëri, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Në këto kushte ai duhet dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 284/2 me 5 (pese) vjet burgim. Ndaj të pandehurit zbatohet neni 406/1 i Kodit të Procedurës Penale, duke u ulur dënimi në 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 3(tre) vjet burgim. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit (për pjesën e mbetur) me burgim ndaj të pandehurit Gerti Gjoshi, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe 3 (tre) vjet.

Në zbatim të nenit 389 të K.Pr.Penale deklarohet heqja e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, caktuar ndaj të pandehurit me vendimin Nr.1338, dt.10.12.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Lidhur me të pandehurin Dashmir Hasanaj lloji i dënimit me burgim dhe masa e tij çmohet duke marrë në vlerësim: Rrezikshmërinë e veprës penale të kryer nga i pandehuri dhe të pasojës së saj. Në këtë kuadër gjykata vëren se vepra penale e “*Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive*”, është parashikuar në K. Penal si kundravajtje dhe jo si krim, gjë që tregon çmimin që legjislatori i ka bërë rrezikshmërisë së kësaj vepre. Gjithashtu, gjykata mban parasysh marrëdhëniet juridike që kjo veprë prek ose cenon, që janë ato të vendosura për të siguruar ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, të jetës së shtetasve nga prodhimi apo mbajtja pa leje e armëve të zjarrit (të gjuetisë apo sportive). Gjykata thekson se vepra penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, përbën krim, për të cilën ligjvënësi parashikon dënimin me burgim nga një deri në tre vjet, që paraqet rrezikshmëri relativisht të lartë shoqërore. Gjithashtu gjykata merr parasysh rrezikshmerinë shoqërore të veprës penale “*Moskallezim Krimi*”, për të cilën dispozita penale parashikon një dënim me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Pra, lloji dhe masa e dënimit me burgim tregon për një shkallë rrezikshmërie jo të lartë të veprës penale. Rrezikshmërinë e autorit i cili rezultoi me gjendje gjyqësore i padënuar. Rrethanat lehtësuese ku bazuar në nenin 48/ç të K. Penal, faktin se i pandehuri pranoi faktin penal, është treguar bashkëpunues me organet e ndjekjes penale. Formën e fajit, i pandehuri e ka kryer veprën me dashje direkte. Gjykata merr parasysh rrethanat familjare ku i pandehuri është kryefamiljar sipas certifikatës familjare si dhe personalitetit të tij referuar karakteristikës së lëshuar nga Njësia Administrative Petrele nr.197/1 prot datë 02.02.2022. Faktin që i pandehuri nuk është përsëritës, pra i padënuar më parë dhe në gjykim ai kerkoi meshire.

Në këto kushte ai duhet dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i K.Penal me 9 (nente) muaj burgim. Për veprën penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit*” parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal e dënon me 1(nje) vit burgim. Për veprën penale “*Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive*”

parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal e dënon me 6 (gjashte) muaj burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit Dashmir Bilal Hasanaj, me 1 (nje) vit e 9 (nente) muaj e 11 (njembedhete) dite burgim. Ndaj të pandehurit zbatohet neni 406/1 i Kodit të Procedurës Penale, duke u ulur dënimi në 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 3(tre) vjet burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (nje) vit e 2 (dy) muaj e 17 (shtatembdhete) dite burgim. Vuajtja e dënimit ka filluar nga dita e ndalimit datë 08.09.2021, i cili është vuajtur me kohen e paraburgimit.

Aplikimi i ketij dënimi është në përputhje të plotë me rëndësinë e faktit, rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe realizon plotësisht qëllimin kompleks të dënimit penal për ndëshkimin, riedukimin e të pandehurit dhe parandalimin e përhapjes së këtyre veprave penale në shoqërinë tonë.

Ne baze të nenit 261 të K.Pr.Penale, gjykata deklaron shuarjen e masës së sigurimit "Arrest në shtëpi" dhënë me vendimin Nr.1601/1, datë 15.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Lidhur me të pandehurën Xhevrije Muça, gjykata në përcaktimin e llojit dhe masës konkrete të dënimit për të pandehurin, në kuadër të respektimit të parimit të individualizimit të dënimit, duhet të vlerësojë këto elemente: Rrezikshmërinë e veprës penale. Përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet gjithmonë me natyrën dhe llojin e saj, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen, pasojat që ka sjellë. Kështu, Gjykata thekson se vepra penale "*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*", parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, përbën krim, për të cilën ligjvënësi parashikon dënimin me burgim nga një deri në tre vjet, që paraqet rrezikshmëri relativisht të lartë shoqërore.

Rrethanat lehtësuese. Në rastin konkret e pandehura tregoi në gjykim pendim të thellë, fakt i cili përbën rrethanë lehtësuese parashikuar nga neni 48/ç të K. Penal; Faktin se e pandehuri nuk është përsëritëse, ajo rezultoi të jetë e padënuar më parë dhe në hetim dhe gjykim ka pranuar fajësinë, gjykata çmon si rrethanë lehtësuese bazuar në nenin 49 të K. Penal. Formën e fajit, i pandehuri e ka kryer veprën me dashje direkte.

Gjykata lidhur me masën e dënimit çmon se masa e kërkuar nga prokurori është në përputhje më tërësinë e rrethanave lehtësuese të evidentuara më sipër. Sa më sipër gjykata çmon se duke u bazuar në dispozitat përkatëse penale, në përputhje me rëndësinë e faktit veprës penale të kryer nga e pandehura, e cila është krim, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të saj e cila rezulton e lartë, qëndrimi pohues e pendues të shprehur në gjykim për veprën e kryer, përhapja e kësaj veprës penale në shkallë vendi, moshë e të pandehurës e cila rezulton të jetë 72 vjeç, si dhe faktin se ajo e ka pranuar akuzën që në fillim dhe ka dhënë të gjitha shpjegimet për rrethanat e kryerjes së veprës penale si edhe rrethanave të mësipërme të çështjes në tërësi, e pandehura duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale "*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*", parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, dhe dënuar me 1 (një) vit burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr. Penale i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurën Xhevrije Muça me 8 (tete) muaj burgim. Gjykata lidhur me masën e dënimit çmon se masa e kërkuar nga prokurori është në përputhje më tërësinë e rrethanave lehtësuese të evidentuara më sipër. Në rastin konkret duke pasur parasysh

rrezikshmërinë e ulët të të pandehures, gjykata çmon se ndaj saj duhet aplikuar alternativa e pezullimit të dënimit me burgim dhe vënies në provë, bazuar në nenin 59 të Kodit Penal, për pjesën e dënimit të mbetur. e pandehura Xhevrije Muça i plotëson kushtet për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë, ndaj gjykata vlerëson së duhet aplikuar dënimi alternativ duke çmuar se në rastin konkret plotësohen tërësisht kërkesat ligjore për zbatimin e nenit 59 të Kodit Penal, ndaj të pandehues në vlerësim të rrethanave lehtësuese të sipërcituara. Kjo alternativë e dënimit në një vlerësim të hollësishëm të rrethanave të mësipërme të çështjes të analizuar, çmohet nga gjykata se do të realizojë njëkohësisht jo vetëm qëllimin e ndëshkimit të të pandehurit për veprën penale të kryer, por edhe atë të rehabilitimit, edukimit dhe riintegritimit të tij në të ardhmen në shoqëri, si dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurës Xhevrije Muça, duke e vënë në provë të pandehurën për një periudhë kohe 16 (gjashtembdhjete) muaj.

Në zbatim të nenit 59/4 të Kodit Penal afati i provës për të pandehurit fillon nga e nesërmeja e shpalljes së vendimit të gjykatës.

Gjykata duhet të shprehet në zbatim të nenit 190/1 gërmat “b” të K.Pr. Penale, provat materiale te sekuestruara sipas proces-verbaleve date 08.09.2021, (bimet narkotike llojit canabis sativa,) të asgjësohen.

Gjithashtu gjykata duhet të shprehet në zbatim të nenit 190/1/b të K. Pr. Penale, provat materiale sekuestruar sipas proces-verbaleve dt.08.09.2021 (nje arme zjarri model 56, kaliber 7.62mm, me nr. serie H4283,nje arme gjuetie e markes Franchi me numer serie AH77630, njezet e nje fisheke kaliber 7.62, njembdhjete fisheke kaliber 12, nje pushke model 56 caliber 7.62mm me nr.K01076, 230 cope fisheke model 56, nje pistolete, me mbishkrimin Zastava 635 cal 8mm P.A T6102715, dhe 8 cope fisheke pa mbishkrim), të kalojnë në favor të shtetit.

Në përfundim të gjykimit në bazë të nenit 190/1/ç të K.Pr.Penale, provat materiale sekuestruar me proceverbalin datë 08.09.2021, (Aparate celulare dhe sendet personale) t’u kthehen personave të cilëve u janë sekuestruar.

Sa më sipër gjykata disponon në referim të neneve, 393 të K.Pr. Penale lidhur me pagimin e shpenzimeve proceduriale të hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore 254.000 (dyqind e pesëdhjete e kater mije leke) i ngarkohen të pandehurve ne menyre solidare.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata pasi u kthye bazuar në nenet 284/2, 278/3, 278/4, 300, 47, 48/ç, 49,të K. Penal dhe në nenet 379, 383, 390, 393, 406/1 të K.Pr. Penale,

VENDOSI:

1.Deklarim fajtor të të pandehurit **Erdit Selman Muça** për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe ne baze te kesaj dispozite dënimit të tij me 5 (pese) vjet burgim.

-Deklarimin fajtor të të pandehurit Erdit Selman Muça, për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit” parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni denimin e tij me 6 (gjashte) muaj burgim.

-Deklarimin fajtor të të pandehurit Erdit Selman Muça, për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit” parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni denimin e tij me 1 (nje) vit burgim.

-Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit Erdit Selman Muça, me 5 (pese) vjet e 6 (gjashte) muaj burgim.

-Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 3(tre) vjet e 8 (tete) muaj burgim.

-Vuajtja e dënimit me burgim për të pandehurin, fillon nga dita e ndalimit, datë 08.09.2021 dhe në baze nenit 18 të Ligjit nr. 81/2020, të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

2.Deklarim fajtor të të pandehurit Kadri Halil Gjoshi për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe ne baze te kesaj dispozite dënimin e tij me 5 (pese) vjet burgim.

-Deklarimin fajtor të të pandehurit Kadri Halil Gjoshi, për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit” parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni denimin e tij me 1 (nje) vit burgim.

-Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit Kadri Halil Gjoshi, me 5 (pese) vjet burgim.

-Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 3(tre) vjet e 4 (kater) muaj burgim.

-Vuajtja e dënimit me burgim për të pandehurin, fillon nga dita e ndalimit, datë 08.09.2021 dhe në baze nenit 18 të Ligjit nr. 81/2020, të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

3.Deklarim fajtor të të pandehurit Alfred Selman Muça për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe ne baze te kesaj dispozite dënimin e tij me 5 (pese) vjet burgim.

-Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr. Penale i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Alfred Selman Muça me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

□ Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit (per pjesen e mbetur) me burgim ndaj të pandehurit Alfred Selman Muça, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe 3 (tre) vjet, me kusht që të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë, gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale.

-Në zbatim të nenit 60, pika 9 të Kodit Penal, i pandehuri Alfred Selman Muça urdhërohet që gjatë periudhës së provës të mos shoqërohet me persona të dënuar me parë.

-Në zbatim të nenit 389 të K.Pr.Penale deklarohet heqja e masës së sigurimit “Arrest ne burg”, caktuar ndaj të pandehurit me vendimin Nr.1562 akti, dt.12.09.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

4.Deklarim fajtor të të pandehurit Lulzim Demir Çullhai për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe ne baze te kesaj dispozite dënimit e tij me 5 (pese) vjet burgim.

-Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr. Penale i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Lulzim Demir Çullhai me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

□Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurit Lulzim Demir Çullhai, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe 3 (tre) vjet, me kusht që të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë, gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale.

-Në zbatim të nenit 60, pika 9 të Kodit Penal, i pandehuri Lulzim Demir Çullhai urdhërohet që gjatë periudhës së provës të mos shoqërohet me persona të dënuar me parë.

-Në zbatim të nenit 389 të K.Pr.Penale deklarohet heqja e masës së sigurimit “Detyrim per t’u paraqitur ne policine gjyqesore”, caktuar ndaj të pandehurit me vendimin Nr.1562/1 akti, dt.18.01.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

5.Deklarim fajtor të të pandehurit Gerti Halil Gjoshi për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe ne baze te kesaj dispozite dënimit e tij me 5 (pese) vjet burgim.

-Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr. Penale i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Gerti Halil Gjoshi me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

□Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit (per pjesen e mbetur) me burgim ndaj të pandehurit Gerti Halil Gjoshi, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe 3 (tre) vjet, me kusht që të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë, gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale.

-Në zbatim të nenit 60, pika 9 të Kodit Penal, i pandehuri Gerti Halil Gjoshi urdhërohet që gjatë periudhës së provës të mos shoqërohet me persona të dënuar me parë.

-Në zbatim të nenit 389 të K.Pr.Penale deklarohet heqja e masës së sigurimit “Arrest ne shtepi”, caktuar ndaj të pandehurit me vendimin Nr.1338, dt.10.12.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

6.Deklarim fajtor të të pandehurit Dashamir Bilal Hasanaj për kryerjen e veprës penale “Moskallezim Krimi” parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe ne baze te kesaj dispozite dënimit e tij me 9 (nente) muaj burgim.

-Deklarimin fajtor të të pandehurit Dashamir Bilal Hasanaj, për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni denimin e tij me 1 (nje) vit burgim.

-Deklarimin fajtor të të pandehurit Dashamir Bilal Hasanaj për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive” parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni denimin e tij me 6 (gjashte) muaj burgim.

-Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit Dashamir Bilal Hasanaj, me 1 (nje) vit e 9 (nente) muaj e 11 (njembedhete) dite burgim.

-Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (nje) vit e 2 (dy) muaj e 17 (shtatembedhete) dite burgim.

- Vuajtja e dënimit ka filluar nga dita e ndalimit datë 08.09.2021, i cili është vuajtur me kohën e paraburgimit.

-Ne baze te nenit 261 te K.Pr.Penale, shuarjen e mases së sigurimit "Arrest në shtepi" dhënë me vendimin Nr.1601/1, datë 15.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7.Deklarim fajtor të të pandehurës **Xhevrije Xhemal Muça** për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni denimin e saj me 1 (nje) vit burgim.

-Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr. Penale i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurën Xhevrije Xhemal Muça me 8 (tete) muaj burgim.

□ Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurës Xhevrije Xhemal Muça, duke e vënë në provë të pandehurën për një periudhë kohe 16 (gjashtembedhete) muaj, me kusht që të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë, gjatë kësaj kohe e pandehura të mos kryejë veprë tjetër penale.

8.Në zbatim të nenit 59/4 të Kodit Penal afati i provës për të pandehurit fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës.

9.Në zbatim të nenit 190/1 gërmat “b” të K.Pr. Penale, provat materiale te sekuestruara sipas proces-verbaleve date 08.09.2021, (bimet narkotike llojit canabis sattiva,) të asgjësohen.

10.Në zbatim nenit 190/1/b të K. Pr. Penale, provat materiale sekuestruar sipas proces-verbaleve dt.08.09.2021 (nje arme zjarri model 56, kaliber 7.62mm, me nr. serie H4283,nje arme gjuetie e markes Franchi me numer serie AH77630, njezet e nje fisheke kaliber 7.62, njembedhete fisheke kaliber 12, nje pushke model 56 caliber 7.62mm me nr.K01076, 230 cope fisheke model 56, nje pistolete, me mbishkrimin Zastava 635 cal 8mm P.A T6102715, dhe 8 cope fisheke pa mbishkrim), të kalojnë në favor të shtetit.

11.Në bazë të nenit 190/1/ç të K.Pr.Penale, provat materiale sekuestruar me proceverbalin datë 08.09.2021, (Aparate celulare dhe sendet personale) t'u kthehen personave të cilëve u janë sekuestruar.

12.Shpenzimet proceduriale në fazën e hetimeve paraprake në vlerën 254.000 (dyqind e pesëdhjetë e katër mijë leke) si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehureve në mënyrë solidare.

13.Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga palët brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot në Tiranë, më 22.07.2022.

**SEKRETAR GJYQTARE
SHEFQET SHEHU REXHINA MERLIKA**

SHPENZIMET GJYQËSORE

Për njoftime 900 Lekë